



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. ____ Prot.

Durrës, më _____.____.2024

Lënda: Raporti dhe informimi mbi veprimtarinë e Prefektit të Qarkut për muajt Janar-Dhjetor.

MINISTRISË SË BRENDASHME
DREJTORISË SË ÇËSHTJEVE VENDORE DHE PREFEKTURAVE

TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Prefektit të Qarkut dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Brendshëm, Nr.667 datë 18.12.20148 "Për raportimin dhe informimin mbi veprimtarinë e Prefektit të Qarkut." po Ju dërgojmë raportin në lidhje me veprimtarinë e Prefektit të Qarkut Durrës për muajt Janar-Dhjetor 2023.

Gjatë këtij viti Prefekti i Qarkut Durrës ka organizuar punën duke u përqëndruar kryesisht në këto drejtime:

I. Marrëdhëniet e Prefektit të qarkut me Administratën e Shtetërore:

Takimet kryesore të realizuara gjatë vitit 2023.

Më datë 12.01.2023 Prefekti i Qarkut zhvilloi një takim në kuadër të një prej sfidave që është padyshim një nga prioritetet kryesore të veprimtarisë së punës së qeverisë shqiptare por edhe të asaj vendore që është mjedisi, mbrojtja dhe menaxhimi i tij në të gjithë elementët përbërës, ku ishin të pranishëm:

N/Kryetari i Bashkisë Durrës z.Renis Mullaj, N/Kryetarja e Bashkisë Shijak Znj. Shpresa Domi, Shefi i Sektorit të Policisë Rrugore Z.Dritan Allajbe, Dr i Ndërmarrjes Pastrimit Durrës Z. Leonard Hakaj, Dr.Ndërmarrjes së Pastrimit Plazh Alfred Dhuli, Drejtori i Rrugëve Bashkia Durrës Z. Aljon Hysko, Drejtori i Policisë Bashkiake Z.Vasip Çopa, - Pegjegjes/Sektor i Pyjeve nga Bashkia Krujë Z. Fehmi Mahmutaj, Pergj Sektori nga Dr/Sherbimeve Bashkia Kruje Z.Roland Daja, Pergj Sektori i Emergjencave Civile Bashkia Krujë Z. Xhavit Mullahi, Perfaqësues nga ADZM Z. Naim Herri,

Abdulla Hasanaj, Dr e Zyrës Vendore Arsimore Durrës Znj.Amarilda Thërmija, Dr e Zyrës Vendore Arsimore Krujë Znj.Dorina Laçi, Dr e Zyrës Vendore Arsimore Shijak Znj.Blerina Keçi.

Takimi u fokusua në disa çështje në funksion të përmirësimit të punës dhe angazhimit në drejtim të mbrojtjes së mjedisit si më poshtë:

Aksioni i pastrimit përgjatë vitit 2023 në territorin e Qarkut Durrës - Plani i veprimit dhe informacioni që do të përcillet nga strukturat përgjegjëse.

Menaxhimi i mbetjeve në të tre bashkitë (fondet e planifikuara për këtë qëllim).

Zbatimi i Udhëzimit Nr. 1, datë 24.03.2022 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, "Për nevoja të mbrojtjes së mjedisit, parandalimin e ndotjes në mjedis dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, caktimin e ditës pa makina", i cili përcakton si ditë pa makina të dielën e parë të çdo muaji, nga Bashkitë Durrës, Shijak dhe Krujë, nismë kjo që synon ndërgjegjësimin e qytetarëve së pari për një mjedis më të pastër nga CO2, si dhe për të promovuar përdorimin e mjeteve alternative të transportit jo vetëm për mbrojtjen e mjedisit por dhe për të kursyer karburantin.

Rivitalizim (mbjellja e pemëve) në territorin e bashkive respektive.

Angazhimi i shkollave në aksione pastrimi në bashkëpunim edhe me OJF të ndryshme.

Angazhimi i strukturave në ndërgjegjësimin e komunitetit dhe nxënësve në fushata ndërgjegjësimi për të eliminuar qeset plastike.

Prefekti në fjalën e tij falenderoi gjithë të pranishmit për kontributin e dhënë gjatë vitit 2022 për realizimin e aksionit 1-vjeçar të pastrimit si dhe në të njëjtën kohë kërkoj angazhim maksimal të strukturave përgjegjëse në derjtim të pastrimit të territorit, në vazhdimsi.

Të pranishmit bënë një pasqyrim të punës, informuan për rezultatet konkrete si dhe zhvilluan diskutime të hapura mbi problematikat e hasura, ku dhanë sugjerimet e tyre me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të reja në funksion të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit në punën e tyre të përbashkët.

Më datë 7 mars 2023 Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës ishte i ftuar në një takim kortezie nga Komandati i Anijes “San Marco” (L 9893) Kapiteni Rangut të Parë Z.Marko Stocco, i shoqëruar nga, Atasheu Ushtarak Z.Nicola Piccolo, Kundër Admirali Italian Z.Stefano Konstantino, Nën Kolonel Z.Davide A`Ponte, Shefi i Shtabit të Forcës Detare Kapiteni Rangut të Parë Z.Arsen Mullaj së bashku me pjestarë të ekuipazhit dhe përfaqësues të Forcës Detare.Prefekti shprehu mirënjohje dhe falenderime për këtë vizitë në Portin e Durrësit, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit me Forcat e Armatosura shqiptare, veçanërisht me Forcën Detare si dhe vlerësoi maksimalisht marëdhënien e veçantë të krijuar mes dy vendeve tona e cila me kalimin e viteve ka patur një dinamikë mbresëlënëse si në aspektin kulturor, ekonomik turizmit dhe me gjërë. Anija italiane “San Marco” (L 9893)” bën pjesë në Klasin San Giorgio, dhe është një nga anijet kryesore të Marinës ushtarake Italiane ajo përbëhet nga tre anije luftarake amfibe të tipit aeroplanmbajtëse (LPD): “San Giorgio”, “San Marco” dhe e fundit, me një dizajn paksa më të ndryshëm, “San Giusto”, të specializuara në operacionet e uljes së avionëve luftarakë.

Më datë 23 mars 2023 Prefekti i Qarkut Durrës priti në një takim Kolonel Davide D'Aponte Komandant i Njësisë Kufitare Detare të Guardia di FinanzaDurrës, Togër Marco Prosdócimo, Shef i sallës Operative i Njësisë Kufitare Detare të Guardia di Finanza Durrës, me qëllim prezantimin dhe njohjen me aktivitetin e kësaj njësie në mbështetje të Policisë Kufitare Shqiptare. Gjatë takimit, Prefekti

falenderoi të pranishmit për vizitën, dhe shprehu vlerësimet e tij për marrëdhëniet dy palëshe, duke vendosur theksin te bashkëpunimi i vlefshëm ndërinstitucional, icili me kalimin e viteve është konsoliduar, duke bërë të mundur funksionimin si një organizatë e përbashkët e besueshme dhe profesionale në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme. Në takim palët shprehën angazhimin e tyre të plotë për të vijuar dhe profilizuar më tej, bashkëpunimin, ndërmjet institucioneve, në zhvillimin aktivitetesh të përbashkëta, me qëllim ngritjen e kapaciteteve në ofrimin e shembujve më të mirë, në fusha me interes të veçantë.

Më datë 05.04.2023 u mor pjesë në mbledhjen e organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjesdit, në ambientet e sajë, mbi rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vorë. Kjo mbledhje kishte si qëllim shprehjen e qëndrimit mbi nevojën ose jo të realizimit të procesit të VSM-së, mbi propozimin e bashkisë Vorë për disa ndryshime të PPV-së. Gjatë takimit u diskutuan problematikat kryesore që çuan në rishikimin e këtij plani, ku gjatë periudhës së zbatimit të tij ka pasur ankesa, vështirësi dhe problematika që kanë sjellë si nevojë rishikimin e tij. Ky rishikim plani do të zgjidhë shumë problematika që lidhen me strehimin, zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së kushteve të jetesës, pasi zona është me potenciale social – ekonomike.

Më datë 13.04.2023 në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr.190 dt.15.11.2022 për ngritjen e Task-Forcës me qëllim ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo biodegradueshme", Prefekti i Qarkut Durrës Z. Emiljan Jani zhvilloi një takim ku ishin të pranishëm: ekspert nga Ministria e Turizmit dhe Mjesdit Z. Polikron Horeshka, Znj. Adriana Shtëmbari, Drejtori i Inspektoriatit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut Z.Gjergj Muzhaqi, Specialistë nga Agjencia Rajonale e Mjesdit, Zv/ Kryetarët e Bashkive Durrës, Shijak, Drejtuesit e strukturave të Policive Bashkiake në rang qarku, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Drejtoria e Doganës Durrës.

Në takim u bë një përmbledhje punës së përbashkët, u diskutua mbi masat e marra, problematikat e dala dhe çfarë mund të bëhet më tepër në këtë drejtim. Institucionet përgjegjëse shtetërore monitoruese kanë një rol kyç për garantimin e plotësimit të standarteve të kërkuara nga ligji, si dhe për ndalimin e të gjitha subjekteve që nuk respektojnë rregullat. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri “Për Policinë Bashkiake”, kësaj të fundit i është shtuar kompetenca e verifikimit të respektimit të normave ligjore në lidhje me përdorimin në tregje të qeseve plastike.

Prefekti në fjalën e tij kërkoi nga të pranishmit një qasje të re, vëmendje të shtuar në këtë drejtim, bashkëpunim dhe informim mbi masat e mara, koordinim ndërinstitucional ku fokusi të jetë zbatimi i iniciativave të qeverisë shqiptare, që kanë në thelb mirëqënien e përbashkët për përdorimin racional të mjedisit, reduktimin e nivelit të mbetjeve si dhe parandalimin e dëmtimit të tij, duke mbrojtur njëkohësisht shëndetin tonë e të brezave.

Më datë 04.05.2023 u mor pjesë në mbledhjen e organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjesdit, në ambientet e sajë, mbi rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Kavajë dhe të bashkisë Lezhë. Këto mbledhje kishin si qëllim shprehjen e qëndrimit mbi nevojën ose jo të realizimit të procesit të VSM-së, mbi propozimin e të dy bashkive për disa ndryshime të PPV përkatës. Gjatë takimit u

diskutuan problematikat kryesore që çuan në rishikimin e këtij plani, ku gjatë periudhës së zbatimit të tyre ka pasur ankesa, vështirësi dhe problematika që kanë sjellë si nevojë rishikimin e tyre. Gjithashtu rishikimi i këtyre planeve ka ardh edhe për shkak të ndarjeve administrative e territoriale dhe ndryshimeve të paparishikuara demografike e social ekonomike. Këto rishikime planesh do të rrisin zhvillimin ekonomik të zoave si dhe do të zgjidhin shumë problematika që lidhen me lejet e ndërtimit e të zhvillimit të aktiviteteve dhe zonave urbane e turistike.

Më datë 25.05.2023, u organizua një takim koordinues në lidhje me rimobilizimin e të gjitha strukturave përgjegjëse në kuadër të ecurisë së Planit Kombëtar të Pastrimit në të gjithë territorin e Qarkut Durrës.

Në takim ishin të pranishëm: Nën/Kryetari i Bashkisë Durrës Z.Renis Mullaj, Drejtori i Policisë Bashkiake Z.Vasip Çopa, Dr i Ndërmarrjes Pastrimit Durrës Z. Leonard Haka, Pergj Sektori nga Dr/Shërbimeve Bashkia Kruje Z.Roland Daja, Dr/Shërbimeve Bashkia Kruje Z. Andi Kupa, Dr Agjensisë Rajonale te Bregdetit Z.Shpetim Çiku ,Kryeinspektor i Policisë Bashkiake Shijak Z. Nazir Keçi, Pergj/Sektorit Urban Bashkia Durrës Z.Aldo Kaçorri , Znj.Enxhi Lila supervizore e pastrimit Bashkia Shijak.

Prefekti kërkoi nga të pranishmit evidentimin e hotspoteve të rënda dhe identifikimin e nevojës për mbështetje nga Ministria e Mbrojtjes, përcaktimin e datave përkatëse dhe vendeve ku do të ndërhyet me aksione pastrimi ku padyshim u kërkua intensitet i shtuar me fokus në zonat përgjatë gjithë vijës bregdetare, akseve rrugore turistike si dhe brezit ranor.

Më datë 31.05.2023 u mor pjesë në mbledhjen e organizuar nga Prefekti i Qarkut Tirane mbi Komitetin e Menaxhimit Të Zonës së Mbrojtur Mjedisore, Parkut Kombetar "Mali i Dajtit".

Në këtë takim, Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura të Tiranës bëri prezantimin e punës 6 mujore për vitin 2023, ku evidentoi disa problematika si dhe parashtroi disa prioritete që duhet të kenë një rëndësi të veçantë. Prefekti kërkoi angazhim maksimal të të gjitha strukturave përgjegjëse me qëllim mbrotjen dhe rritjen e vlerave te zonave te mbrojtura siç është dhe Parku Kombëtar i Dajtit. Disa nga çështjet që u diskutuan ishin;

1. Situata për mbrotjen e pyjeve nga zjarri që ndodhen brenda perimetrit të Parkut Kombëtar të Dajtit gjatë sezonit turistik.
2. Një vëmendje e shtuar për fluksin e madh të turistëve të cilët do të frekuentojnë këto zona me vlera të mëdha dhe potenciale mjedisore.
- 3.Prioritet që duhet të ketë ARZM Tiranë për planifikimin e kërkesave për lëndë drusore nga banorët e zonës brenda parkut.
4. Takim sensibilizimi për marrjen e masave për mbrotjen nga zjarri me përfaqësues të PMZSH, Adminstratorët e Njësive, Sektori i Planifikimit Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave Prefekti Qarkut Tiranë.
5. Çertifikimi i bimëve me vlera turistike të evidentuara në Parkun Kombetar të Dajtit.
6. Marrja e masave nga OSHEE për mirëmbajtjen e linjave të tensionit të lartë për evitimin e rasteve të zjarrit.

Më datë 01.06.2023 në përgjigje të ftesës së ardhur nga AMBU Tiranë, në formë elektronike, pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Durrës, ku kërkohet pjesëmarrje në Konferencën Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri, u mor pjesë në këtë konferencë në ambjentet e ROGNER HOTEL, Tiranë. Kjo Konferencë u organizua në kuadër të mbylljes së Projektit “Mbështetja e BE-së

për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri” EUSIWM, i bashkë-financuar nga Bashkupunimi Austriak për Zhvillim dhe Bashkimi European, në mbështetje të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU). Objekti i kësaj Konference ishte të ndajë me një audiencë gjithëpërfshirëse progresin e bërë me reformën e ujit, nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga projekti EUSIWM, që nga viti 2018.

Koordinimi, bashkëpunimi dhe ndarja e njohurive ndërmjet institucioneve kombëtare kryesore, partnerëve zhvillimorë, shoqërisë civile dhe akademisë ishte mesazhi kryesor i këtij event.

Më datë 04.10.2023 Prefekti i Qarkut pati një takim me Shefin e Seksionit të Qarkullimit Rrugor dhe Shefin e Policisë Bashkiake lidhur me problematika të sigurisë rrugore në drejtim të qarkullimit të mjeteve, parkimit të tyre si dhe mbi masat e marra nga ana e policisë për ndalimin e përdorimit dhe tregëtimit të qeseve plastike jo konform ligjit.

Në këtë takim u diskutua kryesisht mbi gjendjen e sinjalistikës rrugore, vështirësitë në menaxhimin e qarkullimit rrugor si dhe masat që duhet të ndërmeren për të normalizuar fluksin e qarkullimit të mjeteve si dhe për parandalimin e aksidenteve të ndryshme që mund të ndodhin kryesisht në hyrjet daljet e qytetit. Gjithashtu u diskutuan problematikat në lidhje me hapësirat publike, konkretisht zënia e hapësirave publike për parkingje të paligjshme, nga qytetarë që parkojnë makina për shitje, subjektet e makinave që jepen me qera, apo dhe nga persona të tjerë të paautorizuar të zënies së hapësirave publike me objekte të ndryshme etj, duke shkaktuar problematika të shumta për komunitetin.

Nga Prefekti i Qarkut u kërkuar një angazhim dhe koordinim i punës ndërmjet këtyre dy strukturave për një menaxhim më të mirë të situatës për këto problematika për të bërë të mundur lehtësimin e qarkullimit të mjeteve në mënyrë të veçantë në zonat urbane.

Ndër të tjera u kërkuar angazhimi i policisë rrugore si dhe asaj bashkiake për marrjen e masave të mëtejshme për zbatimin e kuadrit ligjor të veprimtarive tregtare të qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme, kryesisht në tregjet Agro-Ushqimore dhe subjektet private e ambulante të kontraktuar nga Bashkitë.

Më datë 13.10.2023 në Pallatin e Kulturës "Aleksandër Moisiu", u mor pjesë në konsultimin publik të organizuar nga Bashkia Durrës mbi planin e politikave dhe investimeve të bashkisë për ndryshimet klimatike. Bashkia e Durrësit ka marrë përsipër të bëhet pjesë e grupit të bashkive të Evropës të cilat marrin masa për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës në kuadër të politikave dhe masave kombëtare dhe rajonale duke u bërë pjesë e këtij grupi, ku do të ketë mundësinë të përfitojë mbështetje nga Bashkimi Evropian. Me qëllimin për të përfituar këtë mbështetje, Bashkia ka punuar prej disa muajsh me GIZ GmbH dhe Institutin e Kërkimeve Urbane (URI) për të hartuar një inventar fillestar të gazeve serë të shkarkuara nga aktivitetet publike dhe private në territorin e bashkisë, si dhe një vlerësim fillestar të riskut dhe vulnerabilitetit tonë kundrejt ngjarjeve të motit dhe klimës ekstreme. Mbi bazën e rezultateve të marra nga këto studime fillestare, Bashkia ka identifikuar disa masa të zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimit të klimës në sektorë publikë e privatë të bashkisë, të cilat mund të planifikohen dhe zbatohen nga ne. Ndër masat më të rëndësishme që u diskutuan ishin; Masat për zvogëlimin e emisioneve të CO2 në sektorin e ndërtesave, masat për zvogëlimin e emisioneve të CO2

në sektorin e transportit, si dhe masat që synojnë zvogëlimin e konsumit të energjisë dhe ndotjes në sektorin e ndriçimit publik.

II. Drejtimi i Task Forcave Vendore, krijimi i organizmave të përkohshëm, të komiteteve të grupeve të punës dhe të komisioneve për çështje të caktuara:

Task Forca Vendore Antikanabis

Gjatë **periudhës Janar –Dhjetor 2023**, në territorin e Qarkut Durrës dinamika e kriminalitetit me tendencë kultivimin e bimëve narkotike paraqitet si më poshtë :

- Janë kryer 8550 kontrolle, 1719 sera/minisera, 1053 magazina, 327 ish/objekte ushtarake, 379 shtëpi te braktisura, 123 stane/stalla, 4949 ambjente te hapura.
- Janë evidentuar 30 vepra penale, zbuluar 17, me 30 autorë nga të cilët 12 janë arrestuar/ndaluar, 10 ndiqen në gjendje të lirë dhe 8 janë shpallur në kërkim.
- Janë konstatuar 107 ambjente kultivimi, nga të cilat 103 janë ambjente të hapura dhe 4 janë ambjente të mbyllura, me 11.178 bimë narkotike të asgjesuara/sekuestruara, nga të cilat 1104 janë gjetur në tre shtëpi bari dhe 1 miniserë.

KOMITETIT TË MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA MJEDISORE

Në qarkun Durrës janë 4 zona të mbrojtura:

1. Parkun Kombëtar (PK) “Qafë-Shtamë”, shpallur me VKM nr. 102, datë 15.01.1996, sipërfaqe 2000 ha. Me shtesat e VKM nr. 60 datë 26.01.2022 bëhet Park Natyror me një sipërfaqe shtesë rreth 4864 ha . Sipërfaqe totale e saj shkon në 6864.36 ha.
2. Pjesë nga Parku Kombëtar “ Mali i Dajtit” Bovilla shpallur me VKM nr. 402 datë 21.06.2006 me sipërfaqe 2440ha.
3. PTUM “Rrushkull” shpallur me Urdhër Nr.2 MB datë 26.12.1995 me sipërfaqe 564.73ha.
4. PM “Krast-Vrion” shpallur me VKM Nr.468 datë 26.07.2018 me sipërfaqe 1469.23 ha
5. 15 Monumente natyre me VKM nr.303 datë 10.05.20219 me sipërfaqe 833.18 ha.

Totali i sipërfaqes ZM Qarku Durrës shkon në 11365.76 ha.

Po kështu pritet të shtohet me VKM përkatëse edhe PTUM “Bisht Kamëz” me një sipërfaqe 491ha, Me KKT Nr.10 2020.

Totali 11365.76ha +491ha=11856.76ha

Më datë 30 mars 2023 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës u mbajt takimi i Komitetit Rajonal për Zhvillimin e Turizmit 2023. KRZHT është i përbërë nga këto institucione:

1. Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës;
2. Bashkia Durrës (Drejtorja e Policisë Bashkiake, Drejtorja e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin);

3. Drejtoria e Policisë Vendore Durrës;
4. Drejtoria e Policisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Durrës;
5. Agjencina Kombëtare e Bregdetit Durrës;
6. Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
7. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Durrës;
8. Njesia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës (Higjena);
9. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës;
10. Autoriteti Kombëtare i Ushqimit Durrës;
11. Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër;
12. Drejtoria e Përgjithshme Detare (Kapiteneria) Durrës;
13. Spitali Rajonal Durrës;
14. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Durrës;
15. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës;
16. Autoriteti Portual Durrës;
17. Qendra Muzeore Durrës;
18. Qendra Muzeore Krujë;
19. Shoqata e Turizmit;
20. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
21. Autoriteti Rrugor Shqiptar;

Në këtë takim u diskutuan një mori çështjesh të rëndësishme për sezonin e ri turistik veror 2023, ku të gjithë institucionet e pranishme bënë krahasime midis sezonit të shkuar dhe atij që po vjen, duke trajtuar arritje dhe problematika të hasura. Ndër çështjet më të rëndësishme që kërkojnë përmirësim/zgjidhje janë:

1. Shitësit ambulant në vijën bregdetare;
2. Lypsit;
3. Kolaudimi i aparatit për matjen e ndotjes akustike në zotërim nga NJVKSH Durrës;
4. Mbetjet urbane dhe mbledhja e tyre për shmangien e përhapjes së sëmundjeve infektive;
5. Unifikimi me 1 çadër si pikë vrotimi (jo domosdoshmërisht një kullë vrotimi);
6. Mbrojtja dhe promovimi i zonave të mbrojtura të Qafë Shtamës dhe Kepit të Rodonit;
7. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonat me frekuentim të lart turistik;
8. Mbajtja gjithmonë e lirë e plazheve publike.

Ndër të rejat e këtij sezoni të ri turistik është edhe krijimi i Njesisë së Policisë Detare për monitorimin e hapësirës detare me mjete lundruese të tipit “Jet-Ski”, për dhënien e ndihmës së parë të shtetasve dhe mjeteve lundruese, në rast nevojë (SAR). Në përfundim të takimit Prefekti u la detyrë të pranishmëve hartimin e planeve konkrete të veprimit me afate kohore të përcaktuara, të masave paraprake që do të merren nga çdo institucion në drejtim mbarëvajtjes së sezonit turistik veror 2023. Përcaktimin e qartë të objektivave të punës dhe çfarë kërkohet për 2023 në zbatim të akteve ligjore në mënyrë që të krijojmë jo vetëm klimën e duhur për një turizëm bashkëkohor dhe të standartizuar, por në të njëjtën

kohë të krijojmë mundësinë që sektori i turizmit të shërbejë si një nxitës i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik për qarkun tonë dhe më gjerë.

Më datë 2 maj 2023 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës u mbajt mbjedhja e Task-Forcës për Sezonin Turistik Veror 2023, ku të pranishëm ishin të gjitha institucionet pjesë përbërëse të Task-Forcës si:

1. Bashkia Durrës (Drejtoria e Policisë Bashkiake, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike);
2. Drejtoria e Policisë Vendore Durrës;
3. Drejtoria e Policisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Durrës;
4. Agjensia Kombëtare të Bregdetit Durrës;
5. Inspektoriati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
6. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Durrës;
7. Njesia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës;
8. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës;
9. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Durrës;
10. Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin Durrës;
11. Agjensia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër;
12. Drejtoria Përgjithshme Detare (Kapiteneria) Durrës.

Gjatë këtij takimi u diskutuan një mori çështjesh të rëndësishme për mire organizimin dhe mbarrvajtjen e sezonit të ri turistik veror 2023. Çështjet e trajtuara nga secili institucion ishin:

1. Siguria e *Jet Ski*-ve të cilët janë të pajisura me një *chip* dhe në rast të tejkalimit të perimetrit të sigurisë nga qytetari që po argëtohet me të, *Jet Ski*-a fiket e komanduar në largësi nga zotëruesi i saj;
2. Kalimi i plazheve publike nga 20 % në 30 %;
3. Vendosja me përpikmëri e bovave delimituese 20 m nga bregu për ushtrimin e notit dhe si zone e sigurtë për t'u futurë në deti pushuesit;
4. Pastrami 24 orë i mbetjeve urbane dhe drejtpërdrejt e mbetjeve nga resorted dhe hotelet në zonën e plazhit, ku ky proces kryhet me dy turne 12 orë nga bashkia Durrës dhe 12 orë nga operatori privat i kontraktuar për kryerjen e këtij shërbimi, duke grumbulluar mbetjet në burim direct nga njesitë e shërbimit hoteleri-restorant dy here në ditë: paradite dhe pasdite;
5. Kryerja me urgjencë e procesit të dezinfektimit dhe dezinfektimit përgjatë gjithë vijës bregdetare;
6. Aktivizimi për herë të parë të Agjencisë Policore Detare, e cila ka si qëllim dhe objektiv kontrollin e të gjitha vendbazimeve për mjete lundruese motorrike për argëtim;
7. Marrja e masave dhe ndalimi i të gjithë lypsave dhe shitësve ambulant të paligjshëm në qytet dhe përgjatë vijës bregdetare;
8. Zbulimi, parandalimi dhe ndëshkimi nga Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit për këdo që shkel ligjin për ndotjen akustike pas orës 12:00 të natës nga subjektet përgjatë gjithë vijës bregdetare / zonës turistike. Proces ky, duke fillua nga ky vit nuk i përket më Inspektoriatit të Higjenës, por Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit;

9. Kontrolli dhe certifikimi për cilësinë e ujit të pijshëm në të gjitha subjektet e shërbimit përgjatë vijës bregdetare;
10. Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër e ka organizuar veprimtarinë e saj të kontrollit në dy grupe pune në respektimin e të gjitha kushteve dhe kriterëve që dikton ligji për mbrojtjen e mjedisit nga mbetjet e ndryshme që subjektet lëshojnë.

Mbledhja u mbyll me lënien e detyrave për mirë funksionimin e Task-Forcës, e cila do të jetë në terren gjatë gjithë sezonit turistik veror 2023.

Më datë 30 maj 2023 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës u mbajt mbledhja e Task-Forcës për Sezonin Turistik Veror 2023, ku të pranishëm ishin të gjitha institucionet pjesë përbërëse të Task-Forcës si:

1. Bashkia Durrës (Drejtoria e Policisë Bashkiake, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike);
2. Drejtoria e Policisë Vendore Durrës;
3. Drejtoria e Policisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Durrës;
4. Agjencia Kombëtare të Bregdetit Durrës;
5. Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
6. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Durrës;
7. Njesia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës;
8. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës;
9. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Durrës;
10. Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin Durrës;
11. Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër;
12. Drejtoria Përgjithshme Detare (Kapiteneria) Durrës.

Gjatë këtij takimi u diskutuan një mori çështjesh të rëndësishme për mirë organizimin dhe mbarvajtjen e sezonit të ri turistik veror 2023. Tematika e trajtuar nga mbledhja e Task-Forcës ishte siguria e *Jet Ski*-ve dhe ngritja e 10 vendbazimeve të miratuara nga Bashkia Durrës. Vendbanimet janë një element shumë i rëndësishëm gjatë sezonit turistik, pasi shërbejnë për lundrimin e mjeteve motorike për argëtim *Jet Ski*. Këto mjete motorike ujore janë të pajisura me një *chip* dhe në rast të tejkalimit të perimetrit të sigurisë nga qytetari që po argëtohet me të, *Jet Ski*-a fiket e komanduar në largësi nga zotëruesi i saj. Agjencia Kombëtare e Bregdetit shtoi se vendbanimeve këtë vit përpos plotësimit të kriterëve për marrjen e lishencës si çdo vit, ato do t'i nënshtrohen një procesi certifikimi nga Ministria e Turizmit për sigurinë dhe respektimin e të gjitha standardeve. Pas këtij certifikimi këto vendbanime do të lejohen të jenë funksional për pushuesit. Për kontrollin dhe mbarëvajtjen e këtyre 10 vendbazimeve këtë vit i takon Agjencisë Policore Detare ta kryej këtë detyrim ligjor.

Më datë 31.05.2023 u mor pjesë në takimin e Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore në ambjentet e Prefekturës së Qarkut Tiranë.

Në këtë takim, Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura të Tiranës bëri prezantimin e punës 6 mujore për vitin 2023, ku evidentoi disa problematika si dhe parashtoi disa prioritete që duhet të kenë një rëndësi të veçantë. Prefekti kërkoi angazhim maksimal të të gjitha strukturave përgjegjëse

me qëllim mbrotjen dhe rritjen e vlerave të zonave të mbrojtura siç është dhe Parku Kombëtar i Dajtit. Disa nga çështjet që u diskutuan ishin;

1. Situata për mbrotjen e pyjeve nga zjarri që ndodhen brenda perimetrit të Parkut Kombëtar të
 2. Marrja e masave nga OSHEE për mirëmbajtjen e linjave të tensionit të lartë për evitimin e rasteve të zjarrit.
 3. Një vëmendje e shtuar për fluksin e madh të turistëve të cilët do të frekuentojnë këto zona me vlera të mëdha dhe potenciale mjedisore.
 4. Prioritet që duhet të ketë ARZM Tiranë për planifikimin e kërkesave për lëndë drusore nga banorët e zonës brenda parkut.
 5. Certifikimi i bimëve me vlera turistike të evidentuara në Parkun Kombëtar të Dajtit.
- **Më datë 08/06/2023** u zhvillua një takim paraprak me përfaqësues të Administratës së Zonave të Mbrojtura Durrës-Krujë. Në këtë takim u diskutua paraprakisht mbi problematikat të cilat do të trajtohen në mbledhjen e rradhës të Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore. Ndër të tjera u zhvilluan diskutime dhe mbi përcaktimin e rendit të ditës për mbledhjen e Komitetit dhe për datën në të cilën do të zhvillohet kjo mbledhje.

Më datë 8 qershor 2023 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës u mbajt mbledhja e Task-Forcës për Sezonin Turistik Veror 2023, ku të pranishëm përpos të gjitha institucioneve pjesë përbërëse të Task-Forcës që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me çështjet e vijës bregdetare ishin edhe përfaqësues të 10 vendbazimeve (sipërmarrësit privat) si:

13. Bashkia Durrës (Drejtoria e Policisë Bashkiake, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike);
14. Drejtoria e Policisë Vendore Durrës;
15. Drejtoria e Policisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Durrës;
16. Agjencia Kombëtare të Bregdetit Durrës;
17. Drejtoria Përgjithshme Detare (Kapiteneria) Durrës.

Gjatë këtij takimi u diskutuan një mori çështjesh të rëndësishme për mirë organizimin dhe mbarvajtjen e sezonit të ri turistik veror 2023. Tematika e trajtuar nga mbledhja e Task-Forcës ishte siguria e *Jet Ski*-ve, ngritja e 10 vendbazimeve dhe mbi të gjitha certifikimi i tyre si Operator Turistik nga Ministria e Turizmit. Vendbanimet janë një element shumë i rëndësishëm gjatë sezonit turistik, pasi shërbejnë për lundrimin e mjeteve motorike për argëtim *Jet Ski*. Këto mjete motorike ujore janë të pajisura me një *chip* dhe në rast të tejkalimit të perimetrit të sigurisë nga qytetari që po argëtohet me të, *Jet Ski*-a fiket e komanduar në largësi nga zotëruesi i saj. Agjencia Kombëtare e Bregdetit shtoi se vendbanimeve këtë vit përpos plotësimit të kriterëve për marrjen e lishencës si çdo vit, ato do t'i nënshtrohen një procesi certifikimi nga Ministria e Turizmit për sigurinë dhe respektimin e të gjitha standardeve. Pas këtij certifikimi këto vendbanime do të lejohen të jenë funksional për pushuesit. Problematika madhore e ngritur nga sipërmarrësit dhe institucionet ligjzbatues qendron tek kriteret e kërkuara nga Ministria e Turizmit për certifikim si Operator Turistik, pasi kërkohet një drejtues teknik me arsim të lart në fushat: histori, gjeografi, arkeologji, trashëgimi kulturore, të ketë pesë vite përvojë pune në këtë sektor dhe i pajisur me certifikatën për zotërimin e gjuhës së huaj. Kriteret këto

të përealizueshme për sipërmarrësit e këtyre vendbanimeve. Për kontrollin dhe mbarëvajtjen e këtyre 10 vendbazimeve këtë vit i takon Agjencisë Policore Detare ta kryej këtë detyrim ligjor.

- **Më datë 30.06.2023** Prefekti i Qarkut Durrës në cilësinë e Kryetarit të Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, zhvilloj mbledhjen e këtij Komitetit ku ishin të pranishëm përfaqësues të ADZM, Nën-Prefekti i Qarkut Krujë Z.Rexhep Xheka, dhe përfaqësues të institucioneve fushat e përgjegjësive të cilëve lidhen me menaxhimin e zonave të mbrojtura të Qarkut Durrës.

Qëllimi i mbledhjes ishte prezantimi dhe diskutimi rreth raportit të punës së Administratës së Zonave të Mbrojtura të Qarkut Durrës për periudhën janar-qershor 2023, ku u bë një panoramë e situatës aktuale dhe problematikave kryesore të tre Zonave të Mbrojtura: Krastë-Verjon, Qafë Shtamë dhe Rrushkull.

Prefekti theksoi rëndësinë e madhe që mbart hartimi dhe zbatimi i strategjive të qëndrueshme për menaxhimin cilësor të zonave të mbrojtura mjedisore si një pasuri e përbashkët natyrore dhe njerëzore, promovimi i vazhdueshëm i tyre, përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve për vizitorët si dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për mbrojtjen e këtyre vlerave.

Në fjalën e tij Prefekti u përqendrua në rëndësinë e bashkëpunimit të Administratës së Zonave të Mbrojtura me institucionet dhe strukturat në nivel qarku për të adresuar parandalimin dhe përballimin e situatave të zjarreve, ndërtimet pa leje, guroret dhe furrat e gëlqereve që operojnë në ZMM si dhe aksionet e pastrimit në këto zona.

Gjatë këtij takimi, përpos arritjeve dhe zhvillimeve të ndjekura nga ADZM, u evidentuan edhe disa problematika që kanë të bëjnë me nevojën për investime me qëllim shtimin e kapaciteteve infrastrukturore dhe menaxhuese të tyre në drejtim të rritjes së bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kryesorë vendorë për monitorimin e këtyre zonave, mungesa e planeve të menaxhimit të ZM, ruajtja dhe mirëmbajtja e monumenteve të kulturës në këto ZMM etj.

Prefekti i Qarkut Durrës, gjithashtu u fokusua tek analiza krahasore e rasteve të zjarreve të vitit 2022, për të identifikuar trendet dhe përmirësuar masat për parandalimin dhe menaxhimin e tyre në të ardhmen, duke vënë theksin kryesor tek komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit si elementi kryesor në menaxhimin e situatave emergjente që mund të krijohen si rezultat i rritjes së temperaturave gjatë sezonit veror 2023.

Në përfundim, për të gjithë problematikat e ngritura u lanë detyra konkrete dhe nga Prefekti u kërkuar përgjegjshmëri, angazhim dhe bashkëpunim maksimal të të gjitha strukturave përgjegjëse me qëllim mbrojtjen dhe rritjen e vlerave të këtyre zonave të mbrojtura.

- **Më 14.12.2023** u mor pjesë në takimin e Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore i cili u zhvillua në ambjentet e Prefekturës së Qarkut Tiranë. Në këtë takim, Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura të Tiranës bëri analizën e 6-mujorit të dytë për vitin 2023, ku evidentoi disa problematika si dhe parashtroi disa prioritete që duhet të jenë në vëmendje për vitin e ardhshëm. Disa nga çështjet që u diskutuan ishin; Situata për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri që ndodhen brenda perimetrit të Parkut Kombëtar të Dajtit, rëndësia e grupeve vullnetare, marrja e masave nga OSHEE për mirëmbajtjen e linjave të tensionit të lartë për evitimin e rasteve të zjarrit, pastrimin e degëve të pemëve të prera përgjatë korridorit të linjave, përmirësimin e kushteve për pritjen e turistëve që sa

vijnë dhe shtohen në këto zona me vlera të mëdha dhe potenciale mjedisore, prioritet që duhet të ketë ARZM Tiranë për planifikimin e kërkesave për lëndë drusore nga banorët e zonës brenda parkut, mbajtjen sa më të pastër të territorit, vendosjen aty ku mungon të koshave për mbetjet.

Komiteti Rajonal Antitrafik

Trafikimi 2023

Më datë 09.02.2023 u zhvillua analiza vjetore e KRAT (Komitetit Rajonal Antitrafik). U falenderuan të gjithë strukturat për angazhimin dhe përkushtimin e tyre dhe u nënvizua rëndësia e Strategjisë për Trafikimin e Personave duke ju referuar prioritetëve të misionit të qeverisë dhe u kërkuar angazhimi maksimal i të gjithë strukturave anëtare në drejtim të parandalimit, identifikimit, dhe mbrojtjes së qytetarëve nga ky fenomen. Të gjitha sfidat në fushën e trafikimit dhe hapat e hedhura në këtë drejtim kanë pasur dhe do të kenë mbështetjen e vazhdueshme të Institucionit të Prefektit i cili koordinon punën në nivel rajonal, dhe ka vendosur si një nga prioritetet e tij adresimin e të gjithë problematikave për zgjidhjen minimizimin dhe parandalimin e këtij fenomeni. Kjo tryezë hartoi dhe kalendarin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe sensibilizuese, për vitin 2023 i cili është pjesë e kalendarit Kombëtar Antitrafik hartuar nga zyra koordinatorit kombëtar i cili mbetet ende i hapur për tu pasuruar me aktivitete dhe veprimtari. Më pas u përcaktuan objektivat për vitin 2023 si dhe u miratua Plani i Veprimit për vitin 2023.

Më datë 14.04.2023 është përcjellë informacioni 3 mujor i vëmprimtarisë së KRAT, Urdhërat për ngritjen e KRAT dhe TT si dhe rregullorja e funksionimit të KRAT e miratuar nga të gjithë anëtarët. Më datë 13.07.2023 është përcjellë informacioni 6 mujor i vëmprimtarisë së KRAT.

Muaji Tetor tashmë i quajtur “Muaji Antitrafik” ka qenë i mbushur me aktivitete sensibilizuese dhe ndërgjegjëse në bazë të kalendarit të muajit antitrafik hartuar për këtë qëllim nga Tryeza Teknike. Disa nga aktivitetet me të rëndësishme:

- Takimi për sensibilizimin e komunitetit rom dhe egjiptjan në Qendrën Komunitare Nishtulla.
- Takime me stafet e qendrave shëndetsore në Durrës, Shijak dhe NJMF.
- Takime sensibilizuese për punësimin me fasoneritë në Krujë dhe Durrës.
- Takime me nxënësit e shkollave në të 3 bashkitë e qarkut.

Më datë 31.10.2023 u zhvillua takimi në kuadër të mbylljes së aktiviteteve ndërgjegjëse antitrafik të realizuara gjatë muajit tetor nga Institucionet shtetërore dhe organizatat partnere me qëllim parandalimin e këtij fenomeni.

Pjesmarrës në takim ishin dhe një grup nxënësish të gjimnazit “Gjergj Kastrioti” të cilët me mbështetjen e World Vision prezantuan një draft projekt i cili do t’u vijë në ndihmë fëmijëve në situatë rruge. Ky projekt u përkrah nga P.refekti i Qarkut i cili shprehu gadishmëri të plotë për të mbështetur idetë e tyre për të edukuar dhe ndërgjegjësuar të rinjtë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Draft projekti u mbështet dhe nga institucionet anëtare të KRAT.

Më datë 13.12.2023 është dërguar pranë Koordinatorit Antitrafik veprimtaria e KRAT dhe TT përmuajt Janar-Nëntor 2023.

Për periudhën Janar – Dhjetor janë menaxhuar **pesë (5)** raste në total viktime të mundëshme trafikimi me status **VMT** dhe viktime trafikimi është **(një) 1 VT**, një e rritur e shfrytëzuar për prostitucion e cila është dërguar në qendrën pritëse në Tiranë.

III. Marrëdhëniet e Prefektit me Organet e Vetëqeverisjes Vendore.

Në mbështetje të ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, gjatë vitit 2022 në Institucionin e Prefektit kanë hyrë gjithsej 356 akte të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (Këshilli i Qarkut Durrës, Bashkia Durrës, Krujë dhe Shijak), nga të cilat: Të bazuara në ligj janë 286 akte, të pa bazuara 8 akte dhe me karakter individual 62 akte.

Gjatë vitit 2022 për Këshillin e Qarkut janë vlerësuar 7 akte me karakter individual.

Gjatë vitit 2022 për Bashkinë Durrës janë vlerësuar 32 akte me karakter individual

Gjatë vitit 2022 për Bashkinë Krujë janë vlerësuar 10 akte me karakter individual

Gjatë vitit 2022 për Bashkinë Shijak janë vlerësuar 13 akte me karakter individual

Gjithsej 62 akte me karakter individual.

PASTRIMI

Në zbatim të nismës së Kryeministrit të Shqipërisë dhe Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit për zhvillimin e **Aksionit Kombëtar të Pastrimit "Të çlirojmë territorin nga ndotja mjedisore"** Institucioni i Prefektit përgjatë vitit 2023 ka ndjekur aksione pastrimi dhe zhvilluar takime të vazhdueshme me të gjithë strukturat të cilat janë pjesë e grupeve të punës, për të koordinuar dhe bashkërenduar punën si dhe për tu informuar në mënyrë periodike në lidhje me ecurinë e punës në drejtim të pastrimit të territorit.

Referuar raportimeve mujore për periudhën një vjeçare, në qarkun Durrës janë ndërmarrë aksione të shumta në drejtim të pastrimit të territorit, ku janë angazhuar strukturat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, Degët territoriale, Institucionet Shtetërore në nivel vendor, Institucionet Arsimore, organizata të ndryshme, firma riciklimi dhe kontribues të tjerë.

Më poshtë po paraqesim tabelën përmbledhëse e të gjitha aksioneve të pastrimit për vitin 2023 në ndarë në muaj, ku tregohet numri i hotspotëve të pastruara, personat e angazhuar dhe sasia e mbetjeve të evaduara.

Periudha	Bashkia	Hotspote	Persona të angazhuar	Volumi i mbetjeve (ton)
Janar 2023	Durrës	4	32	74

	Shijak	9	45	24
	Krujë	6	32	8
	Total	19	109	106
Shkurt 2023	Durrës	13	370	1.35
	Shijak	11	65	28
	Krujë	--	--	--
	Total	24	435	29.35
Mars 2023	Durrës	9	230	194.3
	Shijak	17	129	50
	Krujë	5	88	4
	Total	31	447	248.3
Prill 2023	Durrës	8	23	156
	Shijak	4	14	14
	Krujë	6	172	16.3
	Total	18	209	186.3
Maj 2023	Durrës	7	485	61.5
	Shijak	4	51	19
	Krujë	3	47	24
	Total	14	583	104.5
Qershor 2023	Durrës	12	261	155
	Shijak	13	51	173
	Krujë	8	70	163
	Total	33	382	491
Korrik 2023	Durrës	10	136	15.5
	Shijak	10	44	23
	Krujë	7	53	16.5
	Total	27	233	55
Gusht 2023	Durrës	8	166	21
	Shijak	--	--	--
	Krujë	3	34	10
	Total	11	200	31
Shtator 2023	Durrës	3	103	2
	Shijak	4	25	11
	Krujë	5	32	12
	Total	12	160	25
Tetor 2023	Durrës	3	414	0.3
	Shijak	5	27	14
	Krujë	4	17	9
	Total	12	458	23.3

Nëntor 2023	Durrës	4	83	15.3
	Shijak	--	--	--
	Krujë	6	30	5.4
	Total	10	113	20.7
Dhjetor 2023	Durrës	4	70	1
	Shijak	--	--	--
	Krujë	--	--	--
	Total	4	70	1
Totali Vjetor		215	3399	1321.45

Tabela përfundimtare e Aksionit Kombëtar të Pastrimit për vitin 2023 në Qarkun Durrës.

Total	Hot Spote	Persona angazhuar të	Volumi i mbetjeve (ton)
Durrës	85	2373	697.25
Shijak	77	451	356
Krujë	53	575	268.2
Total	215	3399	1321.45

Si në vitin 2022 ashtu dhe në vitin 2023 ka patur një angazhim nga të gjitha strukturat përgjegjëse në nivel qarku të cilat kanë dhënë kontributin e tyre në pastrimin e territorit. Ky aksion mbarëkombëtar pastrimi ka dhënë impaktin e tij shumë pozitiv, ku tani mbajtja pastër e mjedisit shikohet në një këndvështrim tjetër krahasuar me disa vite më parë edhe pse ka ende punë për të bërë. Gjykojmë që ka ardhur momenti të kalohet në një fazë të dytë të qasjes ndaj mjedisit dhe ndotësve të tijë, që përveç forma të tjera të edukimit dhe ndërgjegjësimit, mendojmë që duhet të angazhohen edhe më shumë struktura të tjera ligjzbatuese në identifikimin dhe ndëshkimin e atyre individëve apo subjekteve që ndosin ambjentin në mënyrë të paligjshme dhe padyshim që duhet të jetë prioritet i punës në vitin në vijim.

INFRASTRUKTURA

Gjatë vitit 2023 Prefekti i Qarkut i ka kushtuar rëndësi të veçantë infrastrukturës në nivel qarku, kryesisht të infrastrukturës rrugore në sigurinë e rrugëve nacionale dhe atyre rurale vendore. Në këtë kontekst përgjatë gjithë vitit janë zhvilluar takime të ndryshme me të gjithë strukturat përkatëse si dhe janë trajtuar dhe ndjekur çështje dhe problematika që kanë të bëjnë me infrastrukturën rrugore dhe të gjithë elementët e tyre në drejtim të sigurisë.

Institucioni i Prefektit ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me ARRSH (Drejtorinë e Rajonit Qëndror) dhe Operatorët Ekonomik të kontraktuar nga ARRSH, për rrugët nacionale që janë në zotërim, të kësaj të fundit për zbatimin sa më korrekt të kontratave dhe mirëmbajtjes së rrugëve në

mënyrë cilësore. Nga ana e kontraktorëve për periudhën Janar 2023 – Janar 2024 është punuar për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor kryesisht me zërat e mirëmbajtjes rutinë, në të cila janë përfshirë;

- mbushje dhe nivelim i bankinave,
- pastrimi i karrexhatës nga aluvionet dhe materiale të tjera, prerja e bimesise etj.
- riparimi i guardrelave,
- mbushja here pas here të gropave në rrugë,
- rifreskimi i sinjalistikës vertikale,
- plotësimi i sinjalistikës horizontale (vijëzim shirita gjatësor qëndror dhe anësor 15cm me bojë bikomponente spray),
- riasfaltim të segmenteve rrugore,
- punime të tjera rutine, përfshirë edhe element të sigurisë rrugore, etj.

Institucioni i Prefektit gjithashtu ka monitoruar punën e bashkive dhe strukturave mbështetëse në drejtim të infrastrukturës rrugore e më gjerë, punë e cila ka konsistuar në rehabilitimin e akseve rrugore, kuartallave, trotuareve në lagje të ndryshme të qyteteve. Janë kryer investime në shtrim rrugësh me asfalt, ndicimi e tyre me LED, rinovim të sinjalistikës horizontale në rrugët e qyteteve me qëllim rritjen e sigurisë për këmbësorët por dhe drejtuesit e mjeteve. Janë kryer shërbime të ndryshme në pastrime, larje të rrugëve dhe trotuareve.

Të gjitha këto shërbime, ndërhyrje dhe investime tregojnë për një vëmendje të shtuar të të tre bashkive në Qarkun Durrës në planifikimin dhe alokimin e fondeve në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore, rritjes së cilësisë dhe sigurisë edhe pse mund të themi që duhet të bëhet edhe më tepër në këtë drejtim nga bashkitë.

Gjatë vitit 2023 në takimet e ndryshme që Prefekti i Qarkut ka zhvilluar me të gjithë aktorët përgjegjës në drejtim të infrastrukturës rrugore një kërkesë specifike ka qenë edhe përdorimi i rrugëve alternative apo dytësore, për të lehtësuar trafikun e rënduar në periudha të caktuara kryesisht gjatë periudhave të pikut të qarkullimit të mjeteve. Kështu mund të përmendim; Rrugën dytësore Golem-Plepa me kalim nga ana e Shkëmbit të Kavajës, Gjiri i Lalëzit-Maminas me kalim nga Sukthi, Currila-Durrës me kalim nga kodra etj. Një element i rëndësishëm duhet të jetë edhe ndërgjegjësimi (orientimi) dhe informimi i qytetarëve për përdorimin e këtyre rrugëve alternative me qëllim lehtësimin e trafikut në ditë piku.

Gjatë vitit 2023 si rezultat edhe i dhënies së aseksueshmërisë në sistemin e gjobave Policisë Bashkiake Durrës, konstatohet një përmirësim në kontrollin dhe disiplinimin e mjeteve dhe këmbësorët në respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor.

Problematikë e paraqitur gjatë vitit 2023 në drejtim të infrastrukturës rrugore kanë qenë në lidhje me parikimet e gabuara apo abuzimet në parkingjet publike, ku nga Institucioni i Prefektit janë zhvilluar takime për ndërhyrjen e strukturave përgjegjëse në zgjidhjen sa më të shpejtë të tyre, gjë e cila ka dhënë rezultatet e saj.

RINDËRTIMI

Prefekti I Qarkut gjatë këtij viti ka pasur në vëmendje edhe problematikat e dala nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, kryesisht në drejtim të zonave për rindërtim, rforcimit të pallateve të dëmtuara,

rikonstrukcionit të banesave individuale si dhe në dhënien e granteve dhe dëmshpërblimeve për të gjithë banorët përfitues për kategoritë DS1,DS2 dhe DS3.

Gjatë gjithë periudhës Janar - Dhjetor 2023 në të tre bashkitë e qarkut ka vazhduar ndërtimit i zonave të reja të banuara të cilat në bashkinë **Durrës** janë; Zona 4 Spitallë, Zona 1 Nj. Ad. Manëz, Fshati lalëz Nj. Ad. Ishëm; Në bashkinë **Shijak** është Zona 1; Në bashkinë **Krujë** janë, Zona 1 Nj. Ad. Bupq, Zona 1 Nj. Ad. Thumanë, Zona 1 Nj. Ad Fushë-Krujë dhe Zona 1 bashkia Krujë.

- Në zonën e Spitallës po punohet për ndërtimin në total të 996 apartamente, kantieri më i madh i rindërtimit në vend, i cili është në prag të përfundimit.
- Në zonën 1 Nj. Ad. Manëz ka përfunduar rindërtimi, ku janë ndërtuar 9 pallate të reja me 226 apartamente.
- Në zonën e Ishmit vazhdon ndërtimi i 300 banesave të reja individuale. Gjithashtu është ndjekur puna që po bëhet për ndërtimin e një lagje të re po në Ishëm. Në këtë terren shoqata "Rrënjë Shqiptare" po ndërton 39 shtëpi dhe të gjithë infrastrukturën përkatëse.
- Në bashkinë e Shijakut ka përfunduar procesi i rindërtimit të 31 pallateve me 665 apartamente
- Ka përfunduar rindërtimi në Bupq ku janë sistemuar në apartamentet e tyre 120 familje. ku në qendër të saj janë ndërtuar godina e shërbimeve publike, shkolla e re, palestra si dhe amfiteatri. Kjo zonë po plotësohet me detajet e fundit ku do të vendosen stola, ndriçimi si dhe do të mbjellen pemë
- Po ashtu edhe në Thumanë ka përfunduar ndërtimi i 14 pallateve, 278 apartamenteve dhe 155 banesave individuale
- Në zonën e Fush-Krujës ka përfunduar ndërtimi i 15 pallateve me 100 apartamente si dhe 167 shtëpi individuale
 - Në qytetin e Krujës vazhdon procesi i rindërtimit. Është ndjekur puna që po bëhet në kantieret e rindërtimit të 22 pallateve 5 katëshe për 336 familjet e goditura nga tërmeti, e cila është drejt përfundimit. Gjithashtu edhe blloku i dytë i pallateve po ecën me një ritëm të kënaqshëm, pas një procesi tejet kompleks të shpronësimeve.

- **Rindërtim apo rikonstrukcion në zona të tjera të qyteteve.**

- Gjithashtu nga Institucioni i Prefektit është ndjekur puna që është bërë për rindërtimin apo rikonstrukcionin e pallateve në zona të ndryshme të qyteteve të klasifikuar me shkallë dëmtimi DS3, DS4, si dhe janë ndjekur shorte publikë për ndarjen e apartamenteve. Disa prej tyre përmendim;

Në Durrës janë ndjekur punimet për rindërtimin e një pallati në lagjen 5 të qytetit. Godina e mëparshme u shkatërrua nga tërmeti dhe tashmë në të njëjtin vend po ndërtohet një pallat i ri me standarte evropiane.

Në Bashkinë Durrës është ndjekur shorteu publik ku ju shpërndanë 25 familjeve apartamentet e reja të cilat i përkasin pallatit nr. 30 Rruga “Hysen Myshketa”, Njësia Administrative nr. 3. Shorteu publik me objekt shpërndarjen e këtyre apartamenteve tek qytetarët që u janë prishur shtëpitë nga tërmeti, u

zhvillua në prani të familjeve përfituese, komisionit të posaçëm dhe mediave. Pas shorteut banorëve të këtij pallati ju shpërndanë edhe çelësat e banesave të tyre të reja.

Në bashkinë Durrës janë inspektuar punimet për rforcimin e një pallati në lagjen nr.6, rrua "Hysen Myshketa dhe një tjetri në lagjen nr.8. Këto pallate do të bëjnë të mundur rikthimin në banesat e tyre të reja të 45 familjeve. Në lagjen 18 janë ndjekur punimet për rforcimin e një pallati i cili do të presë 20 familje. Gjithashtu janë ndjekur punimet për rforcimin e një pallati në zonën e plazhit i klasifikuar me shkallë dëmtimi DS4 dhe një pallat tjetër po me shkallë dëmtimi DS4 në lagjen nr. 8.

Në zonën e Fushë Krujës po rikonstruktohen 11 pallate, të cilat kishin nivelin e dëmit DS2 dhe DS3. Banorët e këtyre pallateve, kanë marrë grantet për riparimet e brendshme, ndërsa tani bashkia po riparon dhe po i përforcon nga ana e jashtme.

Në zonën e Krujës po rikonstruktohen 32 pallate, të cilat po riparohen në strukturë, përforcim themeli, përforcim të mureve dhe të elementeve konstruktiv mbajtës aty ku ka dëme më të rënda.

Rindërtimi apo rikonstruksioni i shkollave dhe kopshteve, qendrave shëndetësore, banesave individuale, godinave social - kulturore dhe zonave sportive

Përveç rindërtimit të pallateve dhe banesave të reja puna e sektorit tonë ka qenë edhe në monitorimin e rindërtimit të; shkollave dhe kopshteve, qendrave shëndetësore, banesave individuale, godinave social - kulturore dhe zonave sportive. Më kryesoret përmendim;

- Në Bashkinë Durrës janë inspektuar punimet për shkollën e mesme të bashkuar dhe kopshtin me të njëjtin emër “Rexhep Mezin” e cila po ndërtohet tërësisht e re në Njësinë Administrative të Ishmit. Ndërtimi i kësaj shkolle mundësohet nëpërmjet financimit të KFW-Banka Gjermane për Zhvillim dhe po zbatohet nga FSHZH. Kjo shkollë që do të ketë nxënës dhe 35 fëmijë të kopshtit do të ndërtohet sipas standarteve evropiane. Nga Programi i Rindërtimit kjo njësi përfiton 4 shkolla nga të cilat 3 kanë përfunduar.
- Është ndjekur puna që po bëhet për rindërtimin e shkollës së mesme sportive kombëtare “Benardina Qerraxhia” si dhe të konviktit të kësaj shkolle. Në përfundim të punës 300 nxënës, 200 prej të cilëve do të qëndrojnë në konvikt si dhe stafi pedagogjik do të jenë në godina të reja me kushte dhe standarte evropiane. Gjithashtu edhe shkolla “Eftali Koçi” si dhe kopshti me të njëjtin emër, është në fazën e rindërtimit, e cila në përfundim të punës do të mirëpresë 550 nxënës, 45 fëmijë si dhe stafin pedagogjik.
- Janë inspektuar punimet për rikonstruksionin dhe rforcimin e shkollës 9 vjeçare “14 Nëntori” e cila kishte pësuar dëme si pasojë e tërmetit, si dhe të ndërtimit të palestrës së re të kësaj shkolle. Këto punime po kryhen me financimin e BE nëpërmjet programit #EU4Schools zbatuar nga UNDP. Pas përfundimit shkolla do të ketë 32 klasa, 8 laboratorë, palestër të re, dhomën e shërbimeve mjekësore e psikologjike, fushë sportive të jashtme.
- Janë inspektuar punimet për rikonstruksionin dhe rforcimin e shkollës “Pren Simoni” në Draç në njësinë administrative Ishëm. Rikonstruksioni i kësaj shkolle përfshin edhe çatinë e re si dhe rrethimin e objektit.

- Ndërkohë në fshatin Bizë të njesisë administrative Ishëm po ndërtohet një kopsht i ri i cili mundësohet nga programi EU4Schools, financuar nga BE dhe zbatuar nga UNDP.
- Janë inspektuar punimet për rikonstrukcionin dhe përforcimin e shkollës së mesme të bashkuar “Jusuf Hoti” në njësinë administrative të Katundit të Ri, që financohet nga Qeveria e Danimarkës dhe Qeveria e Mbreterisë së Bashkuar nëpërmjet programit CIS zbatuar nga UNDP. Po kështu u inspektua edhe ndërtimi i godinës së re arsimore ku do të vendoset kopshti dhe shkolla fillore me të njëjtin emër, financuar nga buxheti i bashkisë së Durrësit. Shkolla do të ketë 10 klasa, 3 laboratorë, sallë multifunksionale, bibliotekë, dhomë infermierie e psikologu. Ndërsa godina e re arsimore do të ketë 7 klasa, dy për kopshtin dhe 5 për shkollën fillore, dhomë infermierie e ambiente të tjera. Në përfundim të punimeve 330 nxënës dhe 40 fëmijë do të zhvillojnë procesin mësimor në ambiente me standarte bashkëkohore.
- ❖ Gjithashtu janë ndjekur nga afër punimet për ndërtimin e kopshtit të ri “Isuf Ferra” si dhe të rikonstrukcionit të palestrës që ndodhet pranë këtij kopshti dhe shkollës me të njëjtin emër. Rikonstrukcioni i palestrës dhe kopshti i ri financohen nga Qeveria e Danimarkës dhe ajo e Mbretërisë së Bashkuar, nëpërmjet programit CIS, zbatuar nga UNDP. Në Tetor kopshti i ri do të hapë dyert për 80 fëmijë të cilët do të qëndrojnë në ambiente me standarte bashkëkohore ndërkohë që edhe palestra pas rikonstrukcionit tërësor do ti shërbejë 430 nxenesve të shkollës “Isuf Ferra”.

RIVITALIZIMI

Gjatë vitit 2023 puna Institucionit të Prefektit është orientuar dhe në drejtim të shtimit dhe nxitjes së rivitalizimit (mbjelljes së pemëve) nga njwsiw e vetqeverisjes vednore dhe strukturat pwrgegjegjëse në këtë drejtim, kjo në kuadër të mbrojtjes së mjedisit dhe shtimit të hapësirave të gjelbëra në të gjithë qarkun e Durrësit.

Vëmendje i është kushtuar shtimit të hapësirave të gjelbëra në zona të dëmtuara, në rrugë të ndryshme dhe lulishte të qyteteve, pranë shkollave, në Zonat e Mbrojtura, në zonat turistike apo në vende që nuk ka fare bimësi. Konkretisht disa nga punët e ndjekura nga institucioni i Prefektit dhe strukturat përgjegjëse janë:

- Zëvendësimi i pemëve të dëmtuara nga moti i keq në lagjen nr.16 në bashkinë Durrës.
- Mbjelljet e pemëve në lulishten e lagjes 17 (pemë të llojit “Bli” dhe “Acera”), në lulishten e Mauzoleumit të Dëshmorëve, në zonën e Spitallës, Eco Parkun në Porto Romano, lulishten pranë murit të Kalasë, në shëtitoren e Shkëmbit të Kavajës (“pisha”) si dhe përgjatë shëtitores Taulantia (“Palma”, “Pisha” dhe “Oleandra”).
- Gjithashtu janë mbjellë pemë pranë bustit të Shote Galicës në zonën e Fushë-Krujës dhe fshatin Dukagjin i Ri në zonën e Thumanës. Po ashtu edhe në Nj. Ad. Xhafzotaj të qytetit të Shijakut u mbollën 44 pemë Bli dhe 19 pemë Ullinj.
- Puna e bërë për shëtitoren e re të plazhit të Durrësit, investim me një gjatësi prej 3 km, me gjelbërim të shtuar, parqe dhe hapësira sportive, i cili tashmë është në shërbim të qytetarëve dhe turistëve të shumtë që frekuentojnë bregdetin e qytetit.
- Përmendim aktivitetin e zhvilluar me rastin e ditës së Tokës, te zona e stadiumit në qytetin e Durrësit në të cilin u realizua mbjellja e 25 fidanë pemësh të ndryshme. Në këtë aktivitet morën pjesë;

Kryetarja e Bashkisë bashkë me punonjës, përfaqësues Institucionit i Prefektit, përfaqësues nga AZM Durrës, aktivistët e Rivercleanup, nxënës dhe studentë, si dhe pedagogë, mësues e prindër nga shkolla të Durrësit.

Përgjatë vitit 2023 në vëmendje të Institucionit të Prefektit ka qenë gjithashtu edhe puna e Administratës së Zonave të Mbrojtura Durrës në drejtim të rivitalizimit. Kështu gjatë këtij viti nga Komiteti i Menaxhimit të zonave të Mbrojtura Mjedisore janë ndjekur :

- Aktiviteti mjedisor në kuadër të mbrojtjes së mjedisit dhe shtimit të hapsirave të gjelbërta, ku stafi i AdZM Durrës së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Hamallaj-Perlat zhvilluan një ore mjedisor, ku në fokus ishte njohja me rolin dhe rëndësinë e pyjeve në mjedis. Gjithashtu në ambientet përreth shkollës, të gjithë së bashku bënë të mundur mbjelljen e rreth 25 fidanëve pishë.
- Aktiviteti mjedisor i zhvilluar nga Stafi i AdZM Durrës dhe punonjësit e bashkisë Krujë në bashkëpunim me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar “Selman Daci” në Bubq kjo në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve, ku u mbollën 20 fidanë dekorativ të llojit Manjolë në ambientet përreth.
- Zhvillimi i orës mjedisore në natyrë, me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Pal Zefi ", në fshatin Rrushkull të qytetit të Durrësit. Në fund të orës mjedisore, në ambientet përreth shkollës, u mbollën disa fidanë dekorativ të llojit manjolë.
- Ora mjedisore e zhvilluar në kuadër të Ditës së Tokës, nga specialistë të AdZM Durrës me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Ismet Nanushi" në Kullë të qytetit të Durrës, ku në fund të aktivitetit, u mbollën disa fidanë manjolë në ambjentet përreth shkollës.

Në total nga AdZM Durrës, pjesë e Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore për vitin 2023 janë mbjellur gjithsej 1500 fidanë pishë dhe 100 fidanë Manjolë në disa shkolla të qarkut dhe zona të djegura më parë nga zjarri pjesë të Zonave të Mbrojtura. Ndërkohë rreth 13000 fidanë pishë mesdhetare dhe akacie janë mbjellur (zëvendësime) në objektin Makaresh - Zidoll nga subjekti Hastoci shpk në PM “Krast – Vrion”.

Raportime te veçanta

Më datë 12 qershor 2023 Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës bashkë me Bashkinë Durrës (Drejtoria e Policisë Bashkiake, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike), Drejtorinë e Policisë Vendore Durrës, Drejtorinë e Policisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Durrës dhe Agjensinë Kombëtare të Bregdetit Durrës, si pjesë të Task-Forcës për Sezonin Turistik Veror 2023 ushtruan kontroll në terren në të gjitha vendbanimet e miratuara nga Bashkia Durrës në vijën bregdetare të Qarkut Durrës. Gjatë këtij kontrolli u konstatua se vetëm 6 nga 10 vendbazime ishin ngritur, ndërsa 4 të tjerat ishin në proces. Këtë vit siguria e këtyre vendbanimeve është maksimale, pasi subjektet kanë implementuar një sistem të ri sigurie të teknologjisë së fundit, ku çdo mjet lundruar, hapësira e lundrimit, korridoret hyrëse dhe delimitimi i të gjithë perimetrit për ushtrimin e veprimtarisë lundruese për argëtim janë të komanduara nëpërmjet një harte dixhitale nga celulari i operatorit turistik. Të gjitha mjetet lundruese që u kontrolluan të cilët gjendeshin në vendbazim ishin të regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Mjetëve lundruese, që ndodhet në Drejtorinë e Përgjithshme Detare. Të gjithë subjektet që kishin ndërtuar vendbazimet kishin në bordin e mjetit lundrues

dokumentacionin që duhet të ketë mjeti lundrues gjatë lundrimit. Nga kontrolli i dokumentacionit për zhvillimin e aktivitetit turistik vetëm subjekti “Blue Adriatik sh.p.k”, ishte i paisur me Çertifikatë të Operatorit i Turizmit Detar. Të gjithë subjekteve që kishin ndërtuar këto vendbazimi ju bë qartë rregullat që duhet të zbatojnë mjetet lundruese gjatë lundrimit, për këtë subjekteve ju dorëzua dhe një kujtesë me shkrim nga PKM. Gjatë kontrollit të vijës bregdetare u konstatua që shumica e stacioneve të plazheve nuk kishin të vendosura sinjalizimin dhe kufizimin me bova të zonave të detikuara për not, e cila duhet të jetë deri në 200 m nga bregu.

Më datë 3 tetor 2023 Nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Durrës Z. Emiljan Jani u realizua mbledhja në kuadër të Analizimit të punës së Task-Forcës Ndërinstitucionale për Sezonin Turistik Veror për monitorimin dhe kontrollin e masave mbi zbatimin e detyrimeve ligjore për sigurinë në plazhe gjatë sezonit turistik 2023. Në këtë kontekst mbledhja përfshiu Drejtues të Institucioneve që përbëjnë këtë Task-Forcë ku të pranishëm ishin: Drejtori i Policisë Bashkiake Durrës, Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Dr/Rajonal i Agjencisë së Mjedisit, Shef Sek/ nga Drejtoria Vendore të Kufirit dhe Migracionit, Shef Sek/ nga Drejtoria Vendore të Policisë së Qarkut Durrës, Shef Sek/ nga Drejtoria e M.Z.SH Durrës, Inspektor nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektor nga Inspektoriat Shtetëror Shëndetësor dhe NJVKSH. Në këtë takim u bë analiza e punës së kësaj Task-Force, u paraqitën rezultatet konkrete në fushën e turizmit, u analizuan arritjet dhe problematikat nga të gjithë Institucionet, që ofrojnë shërbime në drejtim të turizmit. Prefekti në fjalën e tij theksoi se ky vit ishte një përvojë e suksesshme e bashkëpunimit mes strukturave, të vetëqeverisjes vendore, degëve territoriale, institucioneve të administratës shtetërore falë të cilëve u siguria një sezon turistik i suksesshëm me tregues të kënaqshëm. Një nga arritjet për këtë sezon turistik ishte edhe themelimi i strukturës së re të Njesisë së Policisë Detare, një bashkëpunim midis Policisë së Shteti dhe Policisë së Kufirit dhe Migracionit për kontrollimin e të gjitha mjeteve motorrike lundrues për argëtim dhe për monitorimin e hapësirës detare me mjete lundruese të tipit “Jet-Ski”, për dhënien e ndihmës së parë pushuesve dhe mjeteve lundruese në rast nevojë. Një strukturë në mbështetje të parandalimit dhe zgjidhjes së problematikave në bregdetin e Qarkut Durrës. Institucioni i Prefektit ka vijuar përgjatë gjithë sezonit turistik që lamë pas të koordinojnë punën mes të gjith strukturave të vetëqeverisjes vendore, degëve territoriale, institucioneve të administratës shtetërore që reagimi dhe veprimi të ishte një i tërë. Ky sezon turistik kishte fluksin më të madh të turistëve brenda një viti në këto tre dekada dhe ishte një histori suksesi, por zhvillimi i mëtejshëm i sektorit të turizmit mbetet një sfidë shumë e madhe për të garantuar qëndrueshmërinë e këtij progresi në vazhdimësi. Në përfundim të takimit u diskutuan problematikat si dhe u lanë detyra konkrete për t’u realizuar në sezonin e ardhshëm turistik 2024, duke vendosur theksin në përmirësimin dhe zgjidhjen e problemeve të evidentuara gjatë sezonit turistik 2023

Me datë 14 nëntor 2023 Prefekti i Qarkut Durrës ishte i pranishëm në ceremoninë solemne të organizuar nga Bashkia Durrës me rastin e “14 Nëntorit”. Kryetarja e Bashkisë së Durrësit, Deputetë të Qarkut, anëtarë të Këshillit Bashkiak, si dhe dhjetëra Veteranë të Luftës Nacional-Çlirimtare, në këtë 14 Nëntor përkujtuan 79 vjetorin e çlirimit të Durrësit nga okupatori nazifashist. Mirënjohje të thellë dhe nderim për sakrificat, kontributin, trimërinë dhe heroizmin e dëshmorëve të qarkut tonë në çdo zonë të tij, në Durrës, në Krujë, Shijak, Ishëm, Maminas, Gjepalaj etj. Ishin pikërisht gjaku, lufta

dhe përpjekjet e tyre që hodhen hapat drejt një besimi të ri dhe një të ardhme ndryshe. 14 Nëntori është një moment kur të gjithë ne duhet të përkulemi me shumë mirënjohje dhe respekt përpara veprës së atyre djemve e vajzave, burrave e grave që qëndruan në vijën e parë të zjarrit, jo vetëm për mbrojtjen e interesave dhe dinjitetit kombëtar, por edhe e fitores mbi çdo rrezik që kërcënon liritë e vendit dhe të ardhmes tonë europiane.

Me datë 16 nëntor 2023Prefekti i Qarkut Durrës ishte i pranishëm në ceremoninë solemne të organizuar nga Bashkia Shijak me rastin e 16 Nëntorit ditës së çlirimit nga pushtuesit nazifashistë. Kryetari i Bashkisë Shijak, Deputetë, Veteranë të Luftës Nacional Çlirimtare në këtë 16 Nëntor përkujtuan 79 Vjetorin e çlirimit të Shijakut nga okupatori fashist. Prefekti në fjalën e tij shprehu nderim dhe mirënjohje për dëshmorët e rënë në luftën për çlirim. Kjo ditë duhet konsideruar si shëmbull qytetarie dhe përgjegjësie për të gjithë ne, mjafton të shohim pas në vite për të kuptuar sfidat e kaluara për të patur një vend të lirë dhe të begatë. Sot pas 79 vitesh jemi krenarë për qëndresën dhe luftën anti fashiste dhe sot e përkujtojmë këtë ditë historike të 16 Nëntorit me respektin dhe mirënjohjen më të madhe për dëshmorët e Shijakut të cilët sakrifikuan jetët e tyre për çlirimin e këtij qyteti të vogël, por plot vlera historike dhe mikpritje.

Me datë 20 nëntor 2023Prefekti i Qarkut Durrës ishte i pranishëm në ceremoninë solemne të organizuar nga Bashkia Durrës në lapidarin simbol të kësaj dite, në përkujtim të “80 Vjetorit të evakuimit të gjithë atyre të rinjve luftëtarë patriotë që u internuan në kampet e përqëndrimit nga nazistët gjatë luftës së dytë botërore”. 20 Nëntori 1943 është një ditë historike, një nga momentet kur secili prej nesh duhet të reflektojë mbi të shkuarën dhe të ardhmen, mbi përpjekjet dhe sakrificat njerëzore deri në humbjen e jetës në emër të një kauze të madhe, në emër të lirisë së atdheut. Mirënjohje dhe respekt për të gjithë ata të rinj që bënë rezistencë antifashiste dhe vuajtën në burgjet dhe kampet e përqëndrimit nazist.

Me datë 26 nëntor 2023Prefekti i Qarkut Durrës ishte i pranishëm në ceremoninë solemne në përkujtim të 26 Nëntorit 1912 ditës së ngritjes flamurit të pavarësisë në Durrës. Në prani të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Z.Bajram Begaj, deputetëve të qarkut, veteranëve, përfaqësuesve të komuniteteve fetare, qytetarëve të Durrësit, Kryetarja e Bashkisë Durrës Znj.Emiriana Sako ngriti flamurin kuq e zi, duke u shprehur se 111 vjet më pas, me solemnitete dhe përgjegjësi festojmë aktin historik që kreu kryetari i parë i bashkisë së Durrësit Hafiz Ali Podgorica duke ngritur flamurin shqiptar më 26 nëntor të vitit 1912. Të gjithë përulemi me respekt përpara të gjithë atyre patriotëve që sakrifikuan gjithçka për pavarësinë e vendit. Historia e vendit tonë ashtu si dhe historia e qytetit është e mbushur me beteja në përpjekje për tu ringritur sa herë që jemi goditur. Ndërsa Prefekti i Qarkut Durrës theksoi se të gjitha këto ngjarje të mëdha të historisë së kombit tonë shërbejnë që brezat të mos harrojnë, që të kujtojnë me mirënjohje paraardhësit e tyre dhe të mbushen me krenari për atdheun, flamurin dhe identitetin kombëtar.

Me datë 29 nëntor 2023Prefekti i Qarkut Durrës ishte i pranishëm në ceremoninë solemne në përkujtim të 29 Nëntor dita e Çlirimit të Shqipërisë nga regjimi fashist. Durrësi dhe e gjithë Shqipëria kujton dhe nderon sot me mirënjohje të thellë heronjtë dhe dëshmorët, që e deshën aq shumë këtë vend! Ashtu si çdo vit tjetër në nderim të kujtimit, heroizmit dhe veprës së të rënëve për lirinë e vendit, në Mauzoleumin e Deshmoreve u organizua një ceremoni zyrtare ku ishin të pranishëm:

Prefekti i Qarkut Durrës Z.Emiljan Jani, Kryebashkiakia e Durrësit, Znj. Emiriana Sako, Kryetari i Qarkut Durrës Z.Alfred Mullaraj, Deputetë të Qarkut si dhe përfaqësues të familjeve të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare. Të pranishmit kryen homazhe në respekt dhe mirënjohje të veprës heroike të këtyre heronjve, vendosën kurora me lule duke u përkulur me nderim përpara aktit heroik të atyre njerëzve që sakrifikuan gjithçka për lirinë dhe pavarësinë vendit.

Më datë 13 dhjetor 2023 Prefekti i Qarkut Durrës organizoi një takim, ku ishin të pranishëm përfaqësues të Institucioneve të administratës shtetërore që ofrojnë shërbime ndaj komunitetit në lidhje me masat e marra si dhe planet e veprimit të hartuara nga ana e tyre mbi mbarrvajtjen e festave të fundvitit dhe fillimit të Vitit të Ri 2024. Në fjalën e tij Prefekti theksoi faktin se ndodhemi përpara festave të fundvitit, çdo institucion duhet të hartoj planet e masave sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, ku të jenë përcaktuar qartë objektivat dhe detyrimet nëpërmjet të cilave të synohet rritja e rendit dhe sigurisë publike dhe ofrimin e shërbimeve sa më të plota ndaj komunitetit. Është e rëndësishme që këto ditë festive të shoqërohen nga një frymë e plotë sigurie, rendi dhe qetësie. Gjithashtu, në kuadër të masave parandaluese për përballimin e situatave të mundshme emergjente përgjatë kësaj periudhe, Prefekti i Qarkut kërkoi nga të gjithë strukturat, gadishmëri të plotë, bashkëpunim dhe bashkërendim të punës mes tyre. Në mënyrë të veçantë, nga Drejtoria e Policisë Vendore u kërkua gadishmëri e plotë me qëllim sigurimin e rendit dhe qetësisë, si dhe parandalimin e veprave kriminale, gjithashtu Policia Rrugore duhet të ketë në vëmendje akset rrugore për një qarkullim sa më normal të automjeteve, si dhe parandalimin e aksidenteve rrugore. Nga ana tjetër për garantimin e rendit është i nevojshëm shtimi i efektivëve në terren dhe kalimi në shërbim të përforcuar. Prefekti kërkoi një vëmendje të veçantë nga Policia Kufitare dhe Migracionit në lidhje me hyrje daljet e vizitorëve dhe udhëtareve në vendin tonë. Bashkëpunimi mes institucioneve të pranishme e veçanarisht midis Policisë së Shtetit dhe Policive Bashkiake ishte thelbësor për parandalimin e hedhjes në treg të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve dhe përdorimin civil, që mund të rrezikonin sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

Më datë 20 dhjetor 2023 Prefekti i Qarkut Durrës priti në një takim kortezie në përfundim të misionit të tij dy vjeçar si Komandant i Njësisë Kufitare Detare të Guardia di Finanza Durrës Kolonel Davide D'Aponte, i cili i dorëzon detyrën Kolonel Francesco Della Corte. Prefekti shprehu mirënjohje për kontributin e vazhdueshëm që shkon përtej kufijve, dhe për punën e shkëlqyer të Kolonel Davide D'Aponte gjatë këtyre dy viteve si dhe i uroj suksese Komandantit të ri Francesco Della Corte në detyrën e drejtimit të Njësisë Kufitare Detare të Guardia di Finanza Durrës. Gjatë takimit, Prefekti falenderoi të pranishmit për vizitën, dhe shprehu vlerësimet e tij për Misionin e Guardia di Finanza, marrëdhëniet dypalëshe duke e vënë theksin tek bashkëpunimi i vlefshëm ndër institucional i cili me kalimin e viteve është konsoliduar duke bërë të mundur funksionimin si një organizatë e përbashkët e besueshme dhe profesionale në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme ashtu edhe në realizimin me efektivitet të operacioneve policore antitrafik. Në takim palët shprehën angazhimin e tyre të plotë për të vijuar dhe profilizuar më tej bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, në zhvillimin aktivitetesh të përbashkëta me qëllim ngritjen e kapaciteteve për thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe.

IV. Për urdhërat dhe udhëzimet e nxjerra nga Prefekti.

Në zbatim të ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 20, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 Institucioni i Prefektit ka nxjerrë 98 Urdhëra të ndryshëm me karakter administrativ.

Gjendja Civile.

Në zbatim të Ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009” Për Gjendjen Civile” zyra e arkivit të gjendjes civile ka lëshuar certifikata të shërbimit të gjendjes civile, duke plotësuar kërkesat e shtetasve .

Duke filluar nga data 01.10.2023 shërbimi i certifikatave ofrohet vetëm elektronikisht (on line), nuk ofrohet më në sportelet e gjendjes civile.

Gjatë vitit 2023 janë lëshuar gjithsej 4404 certifikata.

Emergjencat Civile

Me qëllim unifikimin e raportimit dhe informacionit periodik mujor, tremujor dhe vjetor të Prefektit të Qarkut, bazuar në dispozitat e ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” dhe ligjit Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, pu ju paraqes informacionin e punës për vitin 2023.

U bë rishikimin i planit të shkallës II-të, “Për reagimin ndaj ndotjeve detare nga Hidrokarburet dhe lëndët kimike për vitin 2023”.

Në rishikimin e planit u patën në vëmendje:

Ndryshimet e ndodhura në strukturën përbërëse, skemën e organizimit, si dhe të lajmërimit;

Ndryshimet e ndodhura në asetet e nevojshme për reagimin dhe dislokimin e tyre;

Ndryshimet e ndodhura në personelin që aktivizohet në plan;

Planin e trajnimeve.

Pas konfirmimit nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër u dërgua Plani në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

Duke vlerësuar rolin dhe kontributin e strukturave përgjegjëse, nga përvojat e deritanishme, problematikave të shkaktuara për shkak tërënies së zjarreve (gjatë stinës së verës, me rritjen e temperaturave dhe fluksit të lartë të qarkullimit të mjeteve, turistëve të huaj dhe vendas), si dhe rreshjeve me intensitet të lartë (gjatë periudhës vjeshtë-dimër duke shkaktuar përmytje), me qëllim parandalimin e emergjencave, minimizimin e dëmeve dhe përballimin e situatës që mund të krijohet , u **kërkuam institucioneve që ligji i ngarkon me përgjegjësi në fushën e mbrojtjes civile, planin e punës për vitin 2023, në lidhje me projektet, investimet.**

Tërmeti i datës 15.01.2023 me epiqëndër në Burrel, u ndje edhe në territorin e qarkut Durrës, kryesisht në Bashkinë Krujë. Duke pasur parasysh problematikat që mund të shfaqeshin nga nxjerrja në publik i

informacionit mbi pasojat e tërmetit të datës 15.01.2023, **kërkuam nga strukturat përgjegjëse të bashkisë Krujë përcjelljen e informacionit duke e ndarë në 2 (dy) kategori, si më poshtë:**

Raportimet paraprake ku specifikohet burimi i informacionit (ky informacion do të jetë vetëm për përdorim të brendshëm);

Raportimet nga grupet e konstatimit në bazë të VKM-së 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”. **Informacioni i ardhur nga grupet e konstatimit do të jetë i vetmi burim zyrtar për të gjitha palët e interesuara.**

Pas njoftimit nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (I.GJ.E.U.M), si dhe Shërbimi Meteorologjik Ushtarak (SH.M.U) se **duke nisur nga data 16.01.2023 (ditët në vijim)**, do të karakterizoheshin nga reshje shiu, me intensitet në nivel mesatar - të lartë. Si pasojë e rreshjeve mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve dhe rrëshqitje të dherave. Për këtë arsye u thirr mbledhja jashtë radhe e Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel qarku. **Kërkuam marrjen e të gjitha masave të nevojshme, si më poshtë:**

Paralajmërimin e popullatës, veçanërisht në ato zona ku nisur nga përvojat e deritanishme, janë shkaktuar përmbytje;

Kontrollin e vazhdueshëm të sistemeve të kanaleve kulluese dhe gjendjen funksionale të hidrovorëve; Monitorimin vazhdimisht të gjendjen së argjaturave të lumenjve (Erzen, Ishëm, Gjole, Zezë), digave të ujëmbledhësve dhe të shkarkuesve katastrofikë,

Mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve logjistike dhe burimet njerëzore të forcave operacionale për përballimin e çdo situatë të mundshme.

Menaxhimi i mirë nga ana e strukturave përgjegjëse, si dhe pakësimit të intensitetit të rreshjeve nuk u rregjistruan përmbytje.

Pas publikimit të njoftimit nga Ministria e Mbrojtjes në faqen zyrtare www.mod.gov.al në lidhje me ftesën për të aplikuar në programin “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore” komunikua me 3 bashkitë për të aplikuar, duke u shpjeguar se fondi mund të përfitohet duke përgatitur projektet Brenda datës 10.02.2023 **(me shumë totale financiare jo më të lartë se 100.000.000 lekë)** për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar si dhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile. Në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes është publikuar formati i aplikimit për projektet, si dhe shpallja e thirrjes për aplikim.

Në kuadër të raportimit të zbatimit të Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut ndaj Fatkeqësive, i cili bazohet në 7 (shtatë) objektiva të zërthyer në 38 (tridhjetë e tetë) indikatorë duke vlerësuar rolin dhe kontributin e bashkive, **kërkuam një informacion në lidhje me gjatësinë (të shprehur në km), të rrjetit rrugor të asfaltuar dhe atij të paasfaltuar, në territorin e secilës bashki, me përjashtim të rrjetit rrugor nën inventarin e Autoritetit Rrugor Shqiptar.** Informacioni i ardhur nga të 3 (tre) bashkitë ju dërgua Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në cilësinë e autoritetit më të lartë

koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Në zbatim të VKM-së Nr. 714, datë 11.11.2022 “Për miratimin në parim të marrëveshjes së Republikës së Shqipërisë, njëra palë, dhe Bashkimit Europian, pala tjetër, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Mekanizmin Europian të Mbrojtjes Civile”, duke pasur parasysh që qarku Durrës bën pjesë tek zonat me nivel risku të lartë për ndodhjen e emergjencave civile, Institucioni i Prefektit **morri pjesë në workshop-it 2 (dy) ditor (27-28 shkurt) me temë “Union Civil Protection Mechanism” të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në bashkëpunim me Zyrën e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile në Bruksel.**

Në kuadër të marrjes së masave paraprake për përballimin dhe menaxhimin e situatave të mundëshme emergjente përgjatë sezonit pranverë-verë 2023, **u thirr mbledhja e rradhës e Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut Durrës** me fokus rritjen e gadishmërisë dhe të bashkëpunimit midis strukturave përgjegjëse vendore. Në takim u diskutua mbi situatën e zjarreve, problematikat, masat parandaluese, mbrojtëse dhe reaguese, që duhet të merren nga bashkitë, inspektoriatet dhe institucionet ligjzbatuese, për përballimin e emergjencave sezonale verore me qëllim rritjen e efikasitetit të reagimit në kohë nga të gjithë strukturat ligjzbatuese. U bë një analizë e veprimtarisë së strukturave të Shërbimit Zjarrfikës për vitin e kaluar (2022), në rang qarku, për të nxjerr në pah arritjet dhe konstatuar problematikat e hasura me qëllim përmirësimin e tyre përpara fillimit të sezonit veror. U **kërkuan djekja me prioritet e një sërë çështjesh, të tilla si:**

Të organizohet mbledhja e Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel vendor, në kuadër të masave të marra për përballimin dhe menaxhimin e zjarreve gjatë sezonit pranverë-verë;

Të intensifikohet puna e strukturave përgjegjëse për planifikimin, rritja e bashkëpunimit me drejtuesit e njësisë të vetqeverisjes vendore për sensibilizimin e opinionit publik;

Të organizohet puna për inspektimin e gatishmërisë teknike të mjeteve zjarrfikëse dhe pajisjeve që kanë në dispozicion strukturat e M.Z.SH;

Të rishikohen dhe përditësohen planet e gatishmërisë për emergjencat sezonale verore, duke bërë plotësimet dhe përditësimet e nevojshme;

Të bashkëpunohet me njësitë administrative për ngritjen në çdo fshat të grupeve (skuadrave) vullnetare për shuarjen e zjarreve, të cilat duhet të jenë të trajnuara nga strukturat e M.Z.SH;

Të evidentohen blegtorët dhe zonat që përdoren prej tyre si kullota, si dhe fermerët që kanë plantacione frutikulture, me qëllim marrjen e masave parandaluese dhe rritjen e kujdesit për parandalimin e zjarreve;

Të vendosen tabela sinjalizuese në rrugët me destinacion zonat turistike, ku mundësia e rënies së zjarreve është e lartë;

Të përcaktohen vendfurnizimet me ujë të mjeteve ajrore që mund të përdoren për shuarjen e zjarreve;

Të përditësohen skemat e informimit për mënyrën e komunikimit, të strukturave të M.Z.SH, Policisë së Shtetit, Shërbimit Pyjor dhe strukturave të tjera.

U përgatitën 2 (dy) draft-plane në lidhje me marrjen e masave dhe mënyrën e veprimit gjatë situatave emergjente. Duke vlerësuar rolin dhe kontributin e strukturave përgjegjëse, ju dërguam për rekomandim dhe njohje draft-planet. Marrja e masave të sipërpërmendura në kohën e duhur, para se të fillojë stina e verës, do të bëjë të mundur rritjen e efikasitetit të çdo strukture, për parandalimin, parapërgatitjen, përballimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i zjarreve.

Në kuadër të stërvitjes “Imponimi/Sarex 2023” nën drejtimin e Komandës së Forcës Detare, morrëm pjesë në konferencën fillestare/kryesore planëzuese, me qëllim njohjen e institucioneve pjesëmarrëse me modalitetet kryesore të stërvitjes, koordinimin e veprimeve me strukturat bashkëvepruese, në interes të zhvillimit me sukses të stërvitjes. Qëllimi kryesor i stërvitjes është kryerja e operacioneve të ndalimit detar, zbatimit të ligjshmërisë detare dhe kërkim shpëtimit (SAR), bazuar në skenarët e supozuar.

Morrëm pjesë në takimin e organizuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor me temë: “Prezantimi i metodologjisë së përdorur për ndërtimin e hartave të planifikimit strategjik që do të përfshihen në Programin e Mbështetjes Kombëtare gjatë viteve 2023-2027 në fushën e Mbrojtjes Civile”. Diskutimet mes përfaqësuesve u mbështetën në çështjet të tilla si:

Lobimi,

Menaxhimi i të Dhënave,

Komunikimi,

Sundimi i Ligjit.

Ky takim, do të pasohet nga takime të tjera në kuadër të zbatimit të marrëveshjes mes qeverisë shqiptare dhe qeverisë italiane, në fushën e Mbrojtjes Civile. Njësitë e Vetqeverisjes Vendore - Bashkitë, sidomos ato me nivel risku të lartë, për fatkeqësitë natyrore, do të kenë mundësi në të ardhmen të përfitojnë mbështetje për strukturat e tyre të mbrojtjes civile, duke forcuar kapacitetet e tyre reaguese me qëllim për të garantuar mbrojtjen e jetës së , të gjëse së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit .

Në përgjigje të kërkesës për trajnim nga Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), shprehëm konfirmimin për pjesëmarrje. Në kuadër të mbajtjes së trajnimit, komunikua me të gjithë aktorët, të cilët objekt të punës së tyre, përveç të tjerave, kanë edhe me organizimin e operacioneve të reagimit ndaj ndotjeve detare dhe janë pjesë të Planit të rishikuar të shkallës së II-të “Për reagimin ndaj ndotjeve detare nga hidrokarburet dhe lëndët kimike” nr. 992/1, datë 02.02.2022. Trajnimi ishte me temë: ***“Plani i masave dhe organizimi i grupeve të punës në terren, për reagimin ndaj ndotjes detare shkalla I dhe II, vlerësimi i derdhjes, si dhe impakti i ndotjes në shëndetin publik”***. Nënçështjet me prioritet të trajtuara ishin:

- organizimi i grupeve të punës për reagimin ndaj ndotjes detare shkalla I, II;
- vlerësimi i derdhjes së hidrokarbureve;
- impakti i ndotjes në mjedis, përfshirë florën dhe faunën.

Theksuam rëndësinë e organizimit në terren të stimulimeve të shpeshta, të ndotjes detare me qëllim bashkëpunimin, bashkërendimin e të gjitha institucioneve, të cilat ndër të tjera, objekt të punës së tyre kanë aktivitetin detar dhe mbrojtjen e mjedisit detar.

Në kuadër të detyrimit që **Bashkitë, brenda territorit të tyre administrative, kanë për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave parësore në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, pasi i vendosëm në dijeni se** Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në cilësinë e autoritetit më të lartë koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të rrishtit nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, ka ngritur Sektorin e Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Statistikave për të bërë të mundur raportimin e të dhënave parësore, ju kërkua përcaktimin e një pike kontakti që do të përgjigjet institucionalisht për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave parësore në Bazën e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, jo më vonë se data 20 e çdo muaji.

Menaxhimi i kanaleve në kohën e duhur, para se të fillojë vështësia, do të bëjë të mundur rritjen e efikasitetit të çdo strukture, për parandalimin, parapërgatitjen, përballimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i përmbajtjeve, komunikuam me Bashkitë dhe Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit në lidhje me ***një informacion për pastrimin e kanaleve nën administrim.***

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në cilësinë e autoritetit më të lartë koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të rrishtit nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile organizoi takimin me përfaqësues nga secila Prefekturë në lidhje me:

- Problematikat e hasura gjatë menaxhimit të emergjencave, angazhimit dhe koordinimit të kapaciteteve operacionale në të gjitha nivelet si dhe për zbatimin e detyrimeve të akteve ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me paralajmërimin, monitorimin, njoftimin dhe alarmin në rastet e fatkeqësive natyrore dhe të tjera;
- Masat e marra për përballimin e situatave emergjente që mund të shkaktohen nga zjarret gjatë periudhës qershor- shtator.

Në lidhje me një ndryshim në VKM-në nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, me anë të së cilës u bë e mundur lejimi i blerjes së automjeteve për përdorim gjatë emergjencave civile, nga ana e Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore u komunikua me të 3 (tre) bashkitë me qëllim përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile. Blerja e automjeteve do të bëjë të mundur rritjen e kapaciteteve me automjete të strukturave përgjegjëse vendore, të gatshme për parandalimin dhe efikasitetin në minimizimin e dëmeve dhe përballimin e situatës emergjente që mund të krijohet.

Në kuadër të problematikës të mungesës së hartimit të planeve, hartave të përmbajtjeve në rastet e prurjeve të mëdha/prishjes së mundshme të digave të mëdha, si dhe të mungesës së informacionit nga shfrytëzuesit e digave të ujitjes ju kërkua bashkive një informacion i detajuar në lidhje me numrin e njerëzve në rrezik në zonat e banuara poshtë digave në rast të prishjes së digës/prurjeve të mëdha, si dhe të hartimit të planit të alarmit dhe hartave të përmbajtjeve.

Në pikën 2, të nenit 7, në ligjin nr. 45/2019, përcaktohet se >> Nëse kapacitetet e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore janë të pamjaftueshme për të përballuar situatën e krijuar nga fatkeqësia,

kërkohen kapacitete shtesë nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore fqinje.<<Për këtë qëllim u komunikua me bashkitënë lidhje me deklarin e kapaciteteve të gatshme që Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore vendosin në dispozicion të Institucionit të Prefektit për përballimin e emergjencave civile, në rastet kur përballimi i situatës së krijuar në territorin që administrohet prej tyre, i tejkalon kapacitetet e zotëruara nga ana e tyre.

Në lidhje me zbatimin e detyrimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me paralajmërimin, monitorimin, njoftimin dhe alarmin në rastet e fatkeqësive natyrore dhe të tjera u përgatit një material dhe ju dërgua bashkive.

Në kuadër të zhvillimit gjatë muajit tetor të Sesionit të 78-të të Asamblesë së Përgjithshme një nga çështjet për të cilat do të diskutohet ka të bëjë me raportin tematik për të drejtat e njeriut, të personave të zhvendosur brenda vendit, pasojë e ndryshimeve klimatike (përmbajtje, tërmet, etj.), bazuar në Rezolutën 50/6 të Këshillit për të Drejtat e Njeriut, pas kërkesës për bashkëpunim të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme ju kërkua bashkive një informacion i detajuar.

Bazuar në informacionin e dërguar nga I.G.J.E.U.M dhe Shërbimi Meteorologjik Ushtarak, duke filluar prej orëve të pasdites të datës 01.07.2023 dhe pjesën e parë të ditës së nesërme datë 02.07.2023, për prani të rreshjeve me intensitet të lartë (qarku Durrës ishte një nga qarqet e rrezikuara) dhe mundësia përvërsime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave, njoftuam strukturat përgjegjëse për rritjen e gatishmërisë të strukturave të sistemit të Mbrojtjes Civile që kanë në administrim: hidrovorët, rezervuarët, infrastrukturën rrugore, furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ujë, monitorimin e nivelit të lumenjve dhe çdo strukturë tjetër që është në funksion të menaxhimit të emergjencave civile.

Referuar praktikave (tëderitanishme) të ndjekura në dhënien ndihmë me mallra rezervë shteti, u vlerësua si e nevojshme dhënia e disa orientimeve me qëllim konsolidimin e praktikave në vijimësi. Lëvrimi i mallrave me kërkesë të Prefektit, nisur nga nevoja dhe përgjegjësia për vlerësim sa më objektiv të tyre, u theksua se kërkesa e nevojave konkrete për mallra duhet të jetë e arsyetuar, konkretisht:

- Lidhur me kërkesat për ndihma në raste djegie banese kërkesës duhet ti bashkëngjitet çertifikata familjare e familjes përfituese të ndihmës me mallra rezervë shtetërore, si dhe foto ilustruese të dëmit të shkaktuar nga djegia e banesës;
- Lidhur me kërkesat për ndihmë në raste të një situatë emergjence lokale apo fatkeqësi natyrore duhet të pasqyrohen rrethanat konkrete të situatës në vend, numrin real të familjeve ose gjësë së gjallë të prekur nga situata emergjente apo fatkeqësia natyrore, si dhe numrin konkret të personave përfitues.

Me qëllim përdorimin e Fondit të Kushtëzuar, që buxheti i shtetit i alokon bashkive në fushën e mbrojtjes civile në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, ju kërkua dy degëve të Thesarit që ushtrojnë veprimtarinë në qarkun Durrës, një informacion të detajuar në lidhje

me masën, si dhe me mënyrën që do të përdoret fondi i kushtëzuar, për secilën bashki të qarkut Durrës. Pas marrjes së informacionit, nisur nga kërkesa e bashkisë Durrës mbi mundësinë e blerjes së një mjeti zjarrfikës, me një pjesë të fondit të kushtëzuar me qëllim rritjen e kapaciteteve në mjete për M.Z.Sh-në Durrës, Prefekti thirri në një takim Nën/Kryetarin e bashkisë Durrës (nisur nga fakti që fondi për këtë bashki është i konsiderueshëm, si dhe nga miratimi i ndryshimit të VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, e ndryshuar) në lidhje me fillimin e procedurave për përdorimin e tij. Nisur nga informacioni i marrë nga degët e thesarit (duke e pamundësuar blerjen e mjeteve në fushën e mbrojtjes civile), ju kërkua Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile informacion **në lidhje me mundësinë e përdorimit të një pjese nga fondi i alokaur për blerjen e mjeteve në funksion të emergjencave civile, duke bërë të mundur jo vetëm rritjen e kapaciteteve me automjete të strukturave përgjegjëse të mbrojtjes civile të gatshme për parandalimin por edhe efikasitetit në minimizimin e dëmeve, përballimin e situatës emergjente që mund të krijohet.** Pas komunikimit me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile u informuan bashkitë se shpërndarja e fondit të akorduar për vitin 2023 është bërë sipas informacionit të përcjellë nga ana e tyre.

Në datën 25 korrik, në vijim të detyrave që Ministri i Brendshëm Z. Taulant Balla parashtroi në takimin e datës 21 korrik, si dhe nga takimi i datës 24 korrik me Ministrin e Mbrojtjes Z. Niko Peleshi dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Z. Haki Çako, për administrimin e emergjencave verore, Prefekti i Qarkut, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel qarku, (nisur nga përvoja e deritanishme ndërvite, fluksi i madh i lëvizjes gjatë sezonit veror, temperaturave të larta me të cilat po ndeshet vendi ynë), me qëllim parandalimin, përballimin, minimizimin e dëmeve për shkak të emergjencave të mundshme civile, thirri mbledhjen jashtë rradhe të Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel qarku në një takim të zgjeruar në shkallë qarku, me pjesëmarrjen e të gjitha strukturave drejtuese: të bashkive, strukturat reaguese dhe ato operationale të MZSH-së, përfaqësues të sektorëve të E.Civile, të Shërbimit Pyjor, nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, dhe Administrata e Z.M. Nga raportimet dhe diskutimet u konstatua se janë marrë masa përplanifikimin dhe paralajmërimin e hershëm, shkëmbimin e informacionit në kohë reale dhe organizimin e strukturave për reagim të menjëhershëm në rastet e rënies së zjarreve (veçanërisht në pyje dhe kullota). Vëmendje e veçantë ju kushtua trajtimit dhe bashkëpunimit me strukturat e policisë për identifikimin, evidentimin e zjarrvëniesve të qëllimshme dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të zjarrvënësve. U trajtuan gjithashtu edhe problemet e bashkëpunimit e të angazhimit jo vetëm të strukturave që legjisllacioni në fuqi i detyron në fushën e mbrojtjes civile, por edhe të komunitetit duke shfrytëzuar maksimalisht burimet njerëzore dhe logjistike lokale.

Ju kërkua Nën/kryetarëve mbledhja e Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel vendor në mënyrë që të përcillen tek të gjitha strukturat e bashkive detyrat e dala nga mbledhja.

Pas njoftimit nga Salla Operative e Komisariatit të Policisë Rinas se, **më datë 29.08.2023, ora 13:20** në pjesën juglindore të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit “Nënë Tereza” gjatë kryerjes së punimeve

ishte konstatuar **1 (një) municion i llojit predhë (e pashpërthyer)**, ju përcoll rasti Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për të mbështetur me efektivë të forcave xheniere Policinë e Shtetit, me qëllim heqjen e granatës si dhe eliminimin e rrezikut.

Në datën 26 korrik, Prefekti mbajti një takim me Kryetaren e Bashkisë Durrës Znj. Emiriana Sako në lidhje me rritjen e gadishmërisë nga ana e të gjitha strukturave të varësi, si dhe me mundësinë e përdorimit të fondit të kushtëzuar me qëllim rritjen e kapaciteteve tekniko-operacionale, sidomos për automjete, pajisje për forcat zjarrfikëse. Znj. Sako duke vlerësuar bashkëpunimin dhe rekomandimet evazhdueshme nga ane e Prefektit të Qarkut na njohu me planin e masave të ndërmarrë nga Bashkia Durrës. Për të përballuar me sukses emergjencat e mundshme, është ngritur në datën 15 korrik një nënstacion provizor në zonën e Gjirit të Lalzit, Njësia Administrative Ishëm (nisur ngaproblematika me situatën e zjarreve në zonë gjatë vitit 2022), i cili do të jetë deri në datën 15 shtator i stacionuar në zonë. Në dispozicion të M.Z.Sh, Kryetarja ka urdhëruar Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale, si dhe Ndërmarrjen Rrugë që nga 1 maj autobot secila, të jetë i mbushur gjatë gjithë kohës dhe të vendosen pranë Repartit Zjarrfikës. Më pas, së bashku me Zj. Sako u bë një inspektim në Repartin e M.Z.Sh Durrës, për të parë nga afër gjendjen teknike të mjeteve zjarrfikëse.

Në datën 31 korrik, në kuadër të administrimit të emergjencave verore, Prefekti i Qarkut, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel qarku, me qëllim parandalimin, përballimin, minimizimin e dëmeve për shkak të emergjencave të mundshme civile, mbajti një takim me Nën/Kryetarin e Bashkisë Shijak Z. Ismail Gjergji, organikën e Sektorit të Emergjencave Civile, Shërbimin pyjor. Nga Z. Gjergji duke vlerësuar bashkëpunimin dhe rekomandimet e vazhdueshme nga Prefekti, na njohu me planin e masave të ndërmarrë nga Bashkia Shijak, duke theksuar se të gjitha strukturat kanë rritur gadishmërinë e tyre. Për të raportuar në kohë, një nga punonjësit e Sektorit të Emergjencave është vendosur në çdo Njësi Administrative. Në terren në zonat pyjore veprojnë rojet e pyllit. Mjetet e M.Z.Sh-së Shijak janë në gjendje të mirë teknike. Nën/Kryetari shtoi një problematikë në lidhje me mungesën e rrugëve në zonat që cilësohen si “Fond Pyjor”, pasi në rast zjarri e pamundëson futjen e mjeteve zjarrfikëse. Rekomandimet e dala nga mbledhja janë përcjellë tek të gjitha strukturat. Prefekti nga ana e tij shtoi se përdorimi i Fondit të Kushtëzuar për Mbrojtjen Civile do të ndikojë në reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Bazuar në informacionin e dërguar nga I.G.J.E.U.M dhe Shërbimi Meteorologjik Ushtarak, duke filluar prej orëve të pasdites të datës 05 gusht – 07 gusht, për prani të rreshjeve me intensitet të lartë (qarku Durrës ishte një nga qarqet e rrezikuara) dhe mundësia përvërshe të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave, njoftuam strukturat përgjegjëse në tre bashkitë, si dhe Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit për rritjen e gatishmërisë të strukturave të sistemit të Mbrojtjes Civile që kanë në administrim: hidrovorët, rezervuarët, infrastrukturën rrugore, furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ujë, monitorimin e nivelit të lumenjve dhe çdo strukturë tjetër që është në funksion të menaxhimit të emergjencave civile. Kjo situatë u përsërit përgjatë datave 28 gusht – 30 gusht. Pavarisht rreshjeve, në territorin e qarkut Durrës nuk pati problematika.

Në kuadër të Projektit “TO BE READY” (Itali-Shqipëri-Mal i Zi) pas depozitimit në Institucionin e Prefektit të materialeve të tilla si: broshura, fletëpalosje, postera, ju shpërndanë bashkive me qëllim sensibilizimin e mëtejshëm të qytetarëve në lidhje me emergjencat e mundshme civile.

Në kuadër të projektit të Bashkimit European 2023 “TAIEX”, sipas aplikimit fitues të Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, me qëllim të forcimit, parandalimit të ngjarjeve, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe shpëtimit, në menaxhimin e infrastrukturës dhe operatorët e transportit të mallrave të rrezikshme, me hekurudhë, rrugë dhe det, si Institucioni më i lartë në fushën e mbrojtjes civile në nivel qarku, duke e vlerësuar maksimalisht nismën, u dërgua një përfaqësues në takimet gjatë periudhës 18-19-20 Shtator 2023.

Nisur nga situata e vështirë për shkak të zjarreve në qark përgjatë datave 23-24 shtator, me 12 (dymbëdhjetë) vatra zjarri, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel qarku, u mbajt një takim në datën 26 shtator, me strukturat përgjegjëse në nivel vendor të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Emergjencave Civile, Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit, për të bërë një analizë për zjarrin në fabrikën e bojrave “Deutsch Color”, në autostradën Durrës–Tiranë, fshati Maminas, Njësia Administrative Maminas, Bashkia Shijak. Çështjet mbi të cilat u fokusua takimi ishin:

- Sistemi i Raportimit;
- Reagimi i ndërhyrjes me qëllim izolimin dhe fikjen e zjarrit;
- Kapacitetet logjistike, kryesisht të strukturave të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi mes forcave operacionale në terren;
- Shkaqet.

Në lidhje me zjarrin e mësipërm, pas ezaurimit të kapaciteteve në mjete dhe burime njerëzore në qark, si dhe me qëllim shmangien e rrezikut (për shkak edhe të pranisë së depozitave me lëndë të djegshme brenda perimetrit të fabrikës), ju kërkua Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (si autoriteti më i lartë koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile) mbështetja urgjente me mjete zjarrfikëse të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Në kuadër të marrjes së masave paraprake për përballimin dhe menaxhimin e situatave të mundshme emergjente përgjatë sezonit vjeshtë-dimër, ju komunikua strukturave përgjegjëse vendore pranë 3 (tre) Njësive të Vetqeverisjes Vendore dhe Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit – Rajoni Durrës, të cilat kanë administrim kanalet (kulluese, ujitëse), stacionet e pompimit, rezervuarët, argjinaturat mbajtja e një mbledhje në datën 2 tetor, për të analizuar punën e deritanishme të kryer prej tyre. Menaxhimi në kohën e duhur, para se të fillojnë rreshjet, do të bëjë të mundur rritjen e efikasitetit të çdo strukture, për parandalimin, parapërgatitjen, përballimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i përmbytjeve.

Me qëllim parandalimin, përballimin, minimizimin e dëmeve që mund të shkaktohen nga rreshjet e shiut (përmbytje, rrëshqitje dherrash, bllokime rrugësh, etj.) kërkova nga ana e bashkive marrjen e masave të mëposhtme:

1. Të organizohet mbledhjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel vendor, për të analizuar marrjen e masave parapërgatitore për emergjencat e sezonit vjeshtë-dimër;
2. Të rishikohen dhe përditësohen planet e gatishmërisë për emergjencat e sezonit vjeshtë-dimër, duke bërë plotësimet dhe përditësimet e nevojshme;
3. Rifreskimi i skemave të lajmërimit;
4. Përditësimi i të gjitha të dhënave për resurset që dispononi, bazën materiale dhe teknike nën administrimin shtetëror dhe privat, si dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre në rast situatave emergjente apo fatkeqësie;
5. Identifikimi i burimeve financiare, njerëzore dhe materiale që disponohen në nivel vendor;
6. Gjendja e digave/dambave, rezervuarëve dhe mekanizmave të shkarkimit të tyre;
7. Gjendja teknike e stacioneve të pompimit të hidrovorëve dhe e rrjetit të furnizimit me energji elektrike të tyre;
8. Gjendja teknike e sistemit të ujësjellës-kanalizimeve dhe masat shtesë që duhet të merren nga ndërmarrjet;
9. Gjendja e argjinaturave të lumenjve e pritave malore që rrezikojnë zonat e banuara, objektet dhe tokat bujqësore;
10. Gjendja funksionale e sistemit rrugor kombëtar, urban dhe rural;
11. Mirëmbajtja e çdo sistemi kullimi, e kanaleve të ujërave të larta, të dyta dhe të treta dhe kolektorëve të shkarkimeve, për të parandaluar përmbytjet nëpërmjet angazhimit maksimal të Bordeve të Kullimit në çdo bashki;
12. Rezervat e skorieve dhe të kripës, si dhe shpërndarja e tyre përgjatë segmenteve problematike;
13. Rezervat ushqimore për popullatën dhe gjëjnë e gjallë;
14. Shkëmbimi i informacionit të saktë, në kohë reale në mënyrë që të mundësohet marrja e masave për përballimin e situatave emergjente.

Gjithashtu shpreha kërkesën për të marrë pjesë gjatë punimeve të mbledhjes së Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel vendor. Marrja e masave në kohën e duhur, do të bëjë të mundur rritjen e efikasitetit të çdo strukture, për parandalimin, parapërgatitjen, përballimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i rreshjeve.

Në kuadër të listës së projekteve fituese të financuara nga “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore”, ku pjesë e listës janë dhe projektet e hartuara nga Bashkia Durrës dhe Bashkia Krujë, konkretisht:

1. Bashkia Durrës - Përforcim terreni nga rrëshqitja në zonën e NjA-ve nr.2, nr.4, Ishëm;
2. Bashkia Krujë - Punime për rehabilitimin e shkarkuesit, Rezervuari “Vrijon” dhe sistemim i përroit lagja nr. 3, Kovaçe;

Ju kërkua të dyja bashkive (si autoritetet kontraktore për zbatimin e këtyre projekteve), një informacion në lidhje me ecurinë e zbatimit të projekteve.

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Plani i Veprimit (publikuar në Fletoren zyrtare më datë 24.02.2023) përbën dokumentin themelor të Këshillit të Ministrave që do të drejtojë të gjitha aktivitetet dhe investimet e ardhshme të menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe të tjera, në mënyrë që të planifikohet zvogëlimi i riskut, të parandalohet zhvillimi i risqeve të reja dhe të menaxhohet risku i mbetur. Kjo strategji hap rrugën për hartimin dhe harmonizimin e Strategjisë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor. Duke e vlerësuar maksimalisht këtë proces, kërkuam një informacion mbi progresin, masën e përparimit për hartimin e dokumentit, si dhe hapat e mëtejshme.

Nisur nga situata e zjarreve përgjatë sezonit veror, kapaciteteve në burime njerëzore dhe logjistike ju përcoll kërkesa Drejtorisë së M.Z.SH-së Durrës dhe Reparteve të M.Z.SH-ve Krujë dhe Shijak mbi numrin e mjeteve, gjendjen teknike të tyre dhe personelin.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në cilësinë e autoritetit më të lartë koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, është duke përfunduar punën për kompletimin e paketës së 3 (tre) dokumentave bazë, për të bërë të mundur rritjen e efikasitetit të Sistemit të Mbrojtjes Civile, në lidhje me parandalimin, parapërgatitjen, përballimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i emergjencave civile. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që paraqet ky proces, pasi hartimi i dokumentave është studim i mirëfilltë nga ekspertë të fushave që kanë lidhje me emergjencat civile, si dhe funksionimin e Sistemit të Mbrojtjes Civileju kërkoja bashkive një informacion në lidhje me strukturën organizative e cila mbulon fushën e mbrojtjes civile.

Nisur nga fakti që Qarku Durrës bën pjesë tek zonat me nivel të lartë risku (nga përvoja e deritanishme dhe problematikat e krijuara nga emergjencat civile), nevoja për investime, referuar marrjes së masave parandaluese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile, në të 3 (tre) bashkitë është e madhe. Kryerja e investimeve në fushën e mbrojtjes civile bën të mundur minimizimin e riskut, dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera. Prandaj ju kërkoa Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile si autoriteti më i lartë koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, një informacion nëse programi “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore” do të vijojë edhe vitin e ardhshëm, me qëllim nisjen e përgatitjes së projekteve nga ana e 3 (tre) bashkive.

Në takimin e datës 30.05.2023, në Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile me përfaqësuesit e Sektorëve të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave pranë 12 (dymbëdhjetë) Institucioneve të Prefektëve, në lidhje me problematikat e hasura gjatë menaxhimit të emergjencave, angazhimit dhe koordinimit të kapaciteteve operacionale në të gjitha nivelet, zbatimit të detyrimeve ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes civile, si dhe masat e marra për përballimin e situatave emergjente gjatë periudhës Qershor-Shtator 2023, një ndër çështjet e ngritura për diskutim ishte “Parashikimi nga ana e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të 4% të totalit të buxhetit vjetor në

fushën e mbrojtjes civile”. Duke pasur parasysh rolin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe rolin e Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor (si autoriteti që fushën e veprimtarisë e ka të lidhur me veprimtarinë e Njësive të Vetqeverisjes Vendore), ju kërkova një mendim dhe orientim të specializuar, nëse 4% i totalit të buxhetit të Njesisë së Vetqeverisjes Vendore është vetëm fondi i kushtëzuar që i alokohet Njesisë së Vetqeverisjes Vendore nëpërmjet VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, apo 4% përfshin fondin e mësipërm së bashku me të ardhura të tjera vendore, nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet. Kjo kërkesë ju drejtua për shkak se jemi në periudhën e nisjes së punimeve nga institucionet buxhetore, për hartimin e buxhetit për vitin 2024.

Në kuadër të marrjes së masave paraprake për përballimin dhe menaxhimin e situatave të mundshme emergjente përgjatë sezonit vjeshtë-dimër, për shkak të faktit se qarku Durrës bën pjesë në zonat me nivel risku të lartë për emergjencat civile ju komunikua strukturave përgjegjëse vendore pranë 3 (tre) Njësive të Vetqeverisjes Vendore dhe Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit – Rajoni Durrës, të cilat kanë administrim kanalet (kulluese, ujitëse), stacionet e pompimit, rezervuarët, argjinaturat mbajtja e një mbledhje në datën 2 tetor, për të analizuar punën e deritanishme të kryer prej tyre. Menaxhimi në kohën e duhur, para se të fillojnë rreshjet, do të bëjë të mundur rritjen e efikasitetit të çdo strukture, për parandalimin, parapërgatitjen, përballimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i përmytjeve. Një ndër çështjet e diskutuara ishte situata e vështirë e lumit Ishëm, i cili përgjatë sezonit tërreshjeve del nga shtrati duke shkaktuar përmytje në toka bujqësore, banesa, biznese, në 12 fshatra në Njësitë Administrative: Bubq, Fushë-Krujë dhe Thumanë (nga rreshjet e muajit nëntor 2022 sipërfaqja e përmytur ishte rreth 200 ha). Përmytjet e përvitshme (me material inertesh dhe plastike në tokat bujqësore përgjatë lumit Ishëm) ka shkaktuar dëmtimin e tokave bujqësore, duke ndikuar në aftësinë prodhuese të saj. Duke e gjykuar si të domosdoshme nevojën e një takimi të nivelit teknik, vendimmarrës kërkua nga Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile organizimin e këtij takimi. Paraprakisht, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke shprehur gadishmërinë për mbajtjen e një takimi, na informoi se në lidhje me përmirësimin e mbrojtjes nga përmytja (si pasojë e daljes nga shtrati të lumenjve), në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, me një fond grand prej 2.7 milion USD të Western Balkans Investment Framework po realizon studimin e fizibilitetit për përmirësimin e mbrojtjes nga përmytja në lumenjtë Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosa, ku më pas do të kalohet në projektet e zbatimit dhe realizimin e ndërhyrjeve prioritare dhe të plota në këto lumenj tepër problematik, duke filluar me lumenjtë Ishëm dhe Erzen.

Nisur nga fakti që kemi hyrë në sezonin e rreshjeve, si dhe nga situata e kaluar gjatë datave 3-4 dhe 7-8 nëntor, me qëllim parandalimin, përballimin, minimizimin e dëmeve që mund të shkaktohen nga rreshjet e shiut (përmytje, rrëshqitje dherrash, bllokime rrugësh, etj.), më datë 24.11.2023, në kuadër të detyrave të legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes civile, në ambientet e Institucionit të Prefektit u zhvillua mbledhja e radhës e Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut Durrës, me

tematikë: “Mbi punën e bërë gjatë sezonit veror 2023 në lidhje me situatën e menaxhimit të zjarreve, si dhe masat e marra për parandalimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente që mund të ndodhin gjatë periudhës vjeshtë-dimër, 2023-2024”. Pjesëmarrës në mbledhja ishin drejtues ose përfaqësues të institucioneve dhe që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në territorin e Qarkut Durrës dhe drejtues të strukturave përgjegjëse (me detyra në fushën e mbrojtjes civile) në 3 (tre) Njësitë e Vetqeverisjes Vendore. Nisur nga fakti që qarku Durrës bën pjesë tek një nga zonat me nivel të lartë risku për ndodhjen e fatkeqësive natyrore dhe të tjera, për të qenë pjesëmarrës në takim ftesa ju dërgua Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (në cilësinë e autoritetit më të lartë koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e mbrojtjes civile) dhe Ministrisë së Brendshme - Drejtorisë së Politikave dhe Koordinimit të Prefekturave (si drejtoria që fushën e veprimtarisë e ka të lidhur me veprimtarinë e Prefekturave). Ministria e Brendshme u përfaqësua nga Z. Arben Xhaferri Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Koordinimit të Prefekturave, kurse Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile u përfaqësua nga Z. Leonard Qyra Koordinator në Drejtorinë e Gadishmërisë dhe Përgjigjes Emergjente. Në vëmendjen e strukturave përgjegjëse, kërkoja marrjen e masave të mëposhtme:

- Të rishikohen dhe përditësohen planet e gatishmërisë për emergjencat e sezonit vjeshtë-dimër, duke bërë plotësimet dhe përditësimet e nevojshme;
- Rifreskimi i skemave të lajmërimit;
- Përditësimi i të gjitha të dhënave për resurset që dispononi, bazën materiale dhe teknike nën administrimin shtetëror dhe privat, si dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre në rast situatave emergjente apo fatkeqësie;
- Identifikimi i burimeve financiare, njerëzore dhe materiale që disponohen në nivel vendor;
- Gjendja e digave/dambave, rezervuarëve dhe mekanizmave të shkarkimit të tyre;
- Gjendja teknike e stacioneve të pompimit të hidrovorëve dhe e rrjetit të furnizimit me energji elektrike të tyre;
- Gjendja teknike e sistemit të ujësjellës-kanalizimeve dhe masat shtesë që duhet të merren nga ndërmarrjet;
- Gjendja e argjinaturave të lumenjve e pritave malore që rrezikojnë zonat e banuara, objektet dhe tokat bujqësore;
- Gjendja funksionale e sistemit rrugor kombëtar, urban dhe rural;
- Mirëmbajtja e çdo sistemi kullimi, e kanaleve të ujërave të larta, të dyta dhe të treta dhe kolektorëve të shkarkimeve, për të parandaluar përmbytjet nëpërmjet angazhimit maksimal të Bordeve të Kullimit në çdo bashki;
- Rezervat e skorieve dhe të kripës, si dhe shpërndarja e tyre përgjatë segmenteve problematike;
- Rezervat ushqimore për popullatën dhe gjënë e gjallë;
- Shkëmbimi i informacionit të saktë, në kohë reale në mënyrë që të mundësohet marrja e masave për përbalimin e situatave emergjente.

Në kuadër të projektit TAIEX “Ngritja e kapaciteteve të shërbimit të M.Z.Sh-së në rastet e aksidenteve gjatë transportit të mallrave të rrezikshme në Shqipëri” të organizuar nga Drejtoria e

Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit me qëllim testimin e aspekteve specifike të reagimit në raste aksidentesh gjatë transportit të mallrave të rrezikshme dhe identifikimi i boshllëqeve të mundshme gjatë ndërhyrjes. Institucioni i Prefektit morri pjesë në seminarin dhe ushtrimin gjatë datave 20-21 nëntor. Ditën e parë u krye një ushtrim në terren duke simuluar një aksident gjatë transportit të mallrave të rrezikshme në hekurudhë, ndërsa ditën e dytë u zhvillua diskutimi mbi problematikat dhe përmirësimet e mundshme.

Më datë 08.11.2023, në kuadër të detyrave të legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes civile, në ambientet e Nën/Prefektit të Rrethit Krujë u zhvillua mbledhja e rradhës e Komisionit të Mbrojtjes Civile i Bashkisë Krujë, me tematikë “Mbi masat parandaluese, mbrojtëse dhe reaguese për përballimin e situatave emergjente vjeshtë-dimër, si dhe nevojave për përmirësim”. Nisur nga fakti që një nga risqet më të mëdha (jo vetëm për Bashkinë Krujë, por edhe në qark), është lumi Ishëm (nisur nga përvoja e deritanishme), mungesa e rehabilitimit të argjinaturave deri në grykëderdhje gjatë rreshjeve me intensitet mesatar, del nga shtrati duke përmbytur qindra hektarë toka bujqësore, banesa, biznese (gjatë rreshjeve të nëntorit 2022 sipërfaqja e përmbytur ishte rreth 180ha), për pasojë edhe një dëm të madh financiar, gjatë punimeve të mbledhjes morri pjesë dhe Institucioni i Prefektit duke u përfaqësuar nga Nën/Prefekti i Rrethit Krujë dhe Përgjegjësi (i deleguar) i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, njëkohësisht dhe Sekretari Tekniko i Komisionit të Mbrojtjes Civile në Qark.

Në datën 17.11.2023, në Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës u zhvillua një tryezë pune mbi mbështetjen teknike në fushën e Mbrojtjes Civile në nivel Qarku dhe Bashkie, në kuadër të hartimit dhe miratimit të pakteës së dokumentave strategjike në fushën e mbrojtjes civile. Në takim ishin të pranishëm Prefekti i Qarkut Durrës Z. Emiljan Jani, Znj. Adisa Bala- Drejtore e Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut, Fatkeqësive dhe Parandalimit në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Z. Maksimiljan Dhima ekspert i Projektit “RESEAL” UNDP Shqipëri, Nën Kryetari i Bashkisë Durrës Z. Renis Mullaj, Përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Drejtues dhe Specialistë të Mbrojtjes Civile pranë bashkive të qarkut. Bazuar në detyrimin ligjor për hartimin e këtyre dokumenteve në nivel qarku dhe bashkie, si dhe në referencë të modelit të pilotuar në Qarkun Fier dhe bashkitë e tij, nga stafi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile u realizua prezantimi i:

- Dokumentave Strategjike (AKMC) nga Sektori i Koordinimit Ndërinstitucional dhe Zvogëlimit të Risqeve dhe Fatkeqësive;
- Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror;
- Metodologjia për Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në nivel Qarku dhe në nivel Bashkie;
- Mbi Bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë nga Drejtoria e Rehabilitimit dhe Kompensimit.
- Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030;
- Plani Kombëtar për Emergjencat Civile dhe Metodologjia për hartimin e Planeve të Emergjencave Civile.

Nevoja për investime, referuar marrjes së masave parandaluese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile, në të 3 (tre) bashkitë është e madhe. Kryerja e investimeve në fushën e mbrojtjes civile bën të mundur minimizimin e riskut, dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera. Pas komunikimit me Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile si autoriteti më i lartë koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, ju përcolla bashkive një informacion të detajuar se programi “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore” do të vijojë edhe vitin e ardhshëm, me qëllim nisjen e përgatitjes së projekteve nga ana e tyre paraprakisht. Gjithashtu, për vitin 2024, pjesë e fondit të akorduar në buxhetin e vitit 2024 në programin “Emergjencat Civile”, në Ministrinë e Mbrojtjes, është dhe “Fondi për Digat”. Ky fond, në kuadër të politikës kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit të fatkeqësive natyrore përbën një mekanizëm financiar i cili mbështet rehabilitimin apo rikonstrukcionin e digave të rezervuarëve.

Në kuadër të rishikimit (dhe nëse është e nevojshme përditësimit, brenda datës 31.12.2023) të Dokumentit të Vlerësimit Paraprakt të Rreziqeve nga Përmblytjet si dhe zonat me rrezik potencial për Basenin Ujor Ishëm dhe Basenin Ujor Erzen kërkova nga ana e 3 (tre) Bashkive bashkëpunimin për shkëmbimin e informacioneve të cilat disponojnë mbi përmblytjet e ndodhura në periudhën nga përmblytjet e fundit të marra në konsideratë në Vlerësimin e mëparshëm paraprakt të rrezikut nga përmblytjet e deri më sot(2016 – sot), sipas një formati tip.

Me qëllim përdorimin e fondit të kushtëzuar, në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, kërkova nga 2(dy) Degët e Thesarit të cilat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në territorin e qarkut Durrës, një informacion në lidhje me përdorimin e deritanishëm të fondit të kushtëzuar nga 3 (tre) Njësitë e Vetqeverisjes Vendore.Përdorimi i fondit deri në datën 24 dhjetor, bazuar në informacionin e dërguar Prefektit, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Institucioni	Llogaria ekonomike	Plani	Fakti	Fondet e disponueshme
Bashkia Durrës	231	7.987.124	-	-
	604	38.975.399	25.526.922	13.448.477
Bashkia Krujë	231	16.785.902	-	
	604	4.000.000	1.350.596	
	604	4.907.090	-	4.907.090
Bashkia Shijak	231	5.410.296	Në procedurë prokurimi	-

Në kuadër të rishikimit dhe nëse është e nevojshme përditësimin e “Dokumentit të Vlerësimit Paraprakt të Rreziqeve nga Përmblytjet” si dhe zonat me rrezik potencial për “Basenin Ujor Ishëm dhe Basenin Ujor Erzen” (brenda datës 31.12.2023), kërkova bashkëpunimin e Njësitë të Vetqeverisjes Vendore për shkëmbimin e informacioneve të disponueshme mbi përmblytjet e ndodhura në periudhën nga përmblytjet e fundit të marra në konsideratë në Vlerësimin e mëparshëm

paraprakt të rrezikut nga përmytjet e deri më sot (2016 – sot).Informacioni i ardhur nga strukturat përgjegjëse vendore, pasi u përpunua dhe analizua, ju përcoll Agjencisë Kombëtare të Baseneve Ujore.

Në vijim të takimit të datës 17 nëntor 2023 në Institucionin e Prefektit, “Tryeza teknike në fushën e mbrojtjes civile në nivel Qarku dhe Njësie të Vetqeverisjes Vendore” me përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, mbi hartimin dhe miratimin e paketës me dokumentet strategjike në fushën e mbrojtjes civile duke e gjykuar të arsyeshme (në kuadër të bashkëpunimit mes institucionit të Prefektit dhe Njërive të Vetqeverisjes Vendore) ju propozua Bashkive mundësinë e shtimit të buxhetit dedikuar mbrojtjes civile (përveç fondit të kushtëzuar prej 4% alokuar nga buxheti i shtetit), me fonde shtesë, sipas pikës 2, të nenit 65, pasi hartimi, miratimi i këtyre dokumentave, si detyrim ligjor, përbën studim të mirëfilltë shkencor (nisur nga modeli pilot në Qarkun Fier dhe bashkitë e këtij qarku) dhe mund të jetë e nevojshme (nisur nga burimet tuaja njerëzore) asistimi nga ekspertë, por edhe të nevojës së madhe për marjen e masave në kuadër të zvogëlimit të riskut krahasuar me masën e fondit të kushtëzuar.

Duke pasur parasysh që Bashkia Krujë paraqet nivel të lartë risku për shkak të përmytjeve (gjatë sezonit të rreshjeve) në pjesën fushore, si pasojë e daljes nga shtrati të lumit Ishëm, si dhe zjarreve (gjatë sezonit të verës) kryesisht në pjesën malore të saj, e gjykoj të rëndësishëm njoftimin nga Komisariati i Policisë Krujë (si struktura e cila është në patrullim gjatë 24 orëve duke inspektuar dhe monitoruar çdo situatë të mundshme në territorin të cilin mbulon, në përmbushje të detyrave funksionale) për situatat e mundshme të emergjencave, kërkuam bashkëpunimin e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë (nisur nga fakti që Komisariati i Policisë Krujë është nën varësinë e kësaj drejtorie) në fushën e mbrojtjes civile, përse i përket njoftimit në kohë. Njoftimi në kohë, do të bëjë të mundur rritjen e efikasitetit të çdo strukture (pjesë e Sistemit të Mbrojtjes Civile), për parandalimin, parapërgatitjen, përbalimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i fatkeqësive natyrore dhe të tjera.

Nisur nga fakti që: “Sistemi i mbrojtjes civile është sistemi që kryen funksionin e mbrojtjes civile dhe përfshin aftësitë dhe aktivitetet që synojnë mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit nga dëmtimi ose rreziku i dëmtimit, si pasojë e fatkeqësive, dhe përbëhet nga institucione dhe struktura qendrore të mbrojtjes civile, institucione dhe struktura vendore të mbrojtjes civile, struktura operacionale të mbrojtjes civile”, si dhe në kuadër të hartimit të 3 (tre) dokumentave bazë në fushën e mbrojtjes civile, kërkova nga të 3 (tre) Njësitë e Vetqeverisjes Vendore një informacion në lidhje me strukturën organizative e cila mbulon fushën e mbrojtjes civile. Struktura organizative,bazuar në informacionin e dërguar, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Institucioni	Niveli i Strukturës	Numri i Punonjësve në Bashki	Numri i Punonjësve në Njësitë Administrative
--------------	---------------------	------------------------------	--

Bashkia Durrës	Sektor	2	7
Bashkia Krujë	Sektor	4	7
Bashkia Shijak	Sektor	6	-

Pas njoftimit nga Bashkia Krujë, **më datë 07.12.2023** se në lindje të fshatit Kurcaj të Njesisë Administrative Nikël, si pasojë e rreshjeve (*gjatë ditës së djeshme dhe natën*) ka rrëshqitur një masiv shkëmbi duke bllokuar aksin rrugor që lidh fshatin Kurcaj me qendrën e Njesisë Administrative Nikël, kërkuam nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile mbështetjen me efektivë dhe mjete të Forcave të Armatosura, pasi nga kqyrja e gjendjes në terren ishte e pamundur ndërhyrja me kapacitetet (*në mjete*) të Bashkisë për heqjen e masivit të gurit me përmasa të konsiderueshme. Pas 3 (tre) ditësh punimesh nga ekspertë të Forcave Xheniere, të mbështetura nga strukturat e bashkisë, Policisë së Shtetit u bë shpeëthimi i kontrolluar i masivit të gurit.

Pas njoftimit nga Bashkia Krujë, se në anën lindore të lagjes “*Perlate*”, në qytetin e Krujës (*në pjerësi të faqes së malit*), ka shenja të rrëshqitjes së një masivi guri, duke përbërë rrezik jo vetëm për banesat pranë masivit, por edhe për banesat e tjerra në pjerrësinë e shpatit nën rrugë (në krah të gurit kalon rruga e lagjes, në të cilën është shtrirë linja e furnizimit me ujë të pijshëm), kërkoja mbështetjen me specialist të Forcave Xheniere për të bërë një vlerësim të situatës në terren. Gjatë datës 21.12.2023 u bë vlerësimi në terren nga specialistë të Forcave Xheniere dhe u konkludua se: “Ka një shkëputje të masivit shkëmbor nga bazamenti (duke krijuar zgavra me mundësi shkëputje përsëri). Fillimisht duhet të bëhet një studim gjeologjik i terrenit (pasi është e pamundur vlerësimi vizual i masivit shkëmbor). Mundësia e eliminimit të masivit shkëmbor është e pamundur (pasi rreziku për banesat pranë tij, rreth 50m është i lartë)”. Duke pasur parasysh rolin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (si autoriteti koordinues, bashkërendues, drejtues teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile), kërkoja përcjelljen e situatës pranë Institutit të Gjeoshkencave (si autoriteti i cili monitoron dhe vlerëson rreziqet natyrore si tërmetet, stuhitë, ortekët, përmytjet, thatësitat, zjarret, tektonikën, rrëshqitjet nga shpatet malore dhe kodrinore, erozionin e tokës, etj.) me qëllim kryerjen e studimit gjeologjik (sa më shpejtë të jetë e mundur) për të hartuar më pas një plan për eliminimin e rrezikut nga masivi shkëmbor.

Në kuadër të rishikimit të “*Planit të Shkallës së II-të për Reagimin ndaj Ndotjeve Detare nga Hidrokarburet dhe Lëndët Kimike*”, për vitin 2024, duke marrë në konsideratë, kryesisht:

- Ndryshimet e ndodhura në strukturën përbërëse, skemën e lajmërimit, organizimit dhe bashkëpunimit;
- Ndryshimet e ndodhura në asetet (*pajisjet e nevojshme*) për reagimin dhe dislokimin e tyre;
- Ndryshimet e ndodhura në burimet e personelit që aktivizohet në plan;
- Ndryshimet e ndodhura në personelin e kualifikuar që angazhohet në plan;

- Vlerësimin e riskut mbi bazën e sasisë së hidrokarbureve që qarkullon dhe mjeteve të tjera detare,

duke vlerësuar rolin dhe kontributin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare në këtë proces, si dhe faktit që plani duhet të jetë rishikuar brenda muajit janar 2024, ***kërkuam një takim për të diskutuar mbi elementët e mësipërme.***

Në datën 28.12.2023 morra pjesë në mbledhjen e radhës të Komitetit të Sigurisë të Terminalit të Hidrokarbureve “Romano Port” SH.A, në lidhje me analizën e punës së bërë (që nga mbledhja paraardhëse deri tani), si dhe masat e marra për forcimin e elementëve të sigurisë, garantimin e sigurisë portuale. Në mbledhje morrën pjesë drejtues të: Autoritetit Shtetëror të Sigurisë Detare, Kapitenerisë, Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe Migracionit, Drejtorisë së Doganës, Komandës së Forcës Detare.

Përsa i përket problematikave për shkak të rreshjeve me intensitet, gjatë vitit nuk ka pasur problematika të mëdha (krahësuar me vitin e kalaur 2022). Rastet problematike të regjistruara për vitin 2023, paraqiten si më poshtë:

Gjatë muajit përsa i përket situatave emergjente ***për shkak të rreshjeve me intensitet të lartë gjatë datës 13 qershor*** doli nga shtrati uji në grykëderdhjen e përroit të Bardharit, Lagja Magaze, Njësia Administrative Fushë-Krujë. Dëme në njerëz dhe banesa nuk pati. Bashkëpunimi mes strukturave (Ndërmarrja e Shërbimeve, Sektorët e Rrugëve dhe Kullimit, së bashku me OSSHE, Komisariatin e Policisë Krujë) bëri të mundur brenda një kohe të shkurtër kthimin e zonës në normalitet.

Si pasojë e rreshjeve me intensitet të lartë nga data 1-2 korrik pati përmbytje në Bashkinë Krujë, kryesisht në Njësinë Administrative Fushë-Krujë (pati prani uji në objektin e xhamisë dhe inerte në rrugët afër xhamisë), si dhe në Njësinë Administrative Cudhi (aksi rrugor Krujë-Cudhi në pjesën e fshatit Bruz). Për kthimin në normalitet të situatës, u bashkëpunua ngushtë mes strukturave përgjegjëse vendore kryesisht të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike (të cilat ndërhyjnë për të hequr inertet në aksin rrugor Krujë-Cudhi) dhe bizneseve private të cilat kanë në menaxhim mirmbajtjen e akseve rrugore (Ura Gjole-Ishëm, Fushë Krujë-Thumanë, Fushë Krujë-Krujë).

Si pasojë e rreshjeve me intensitet mesatar deri të lartë gjatë datave 3-4 nëntor, u regjistrua vetëm një problematikë, në urën mbi lumin Erzen në qytetin e Shijakut, ku si pasojë e ardhjes të materialeve plastike dhe trungjeve, rrezikohej dalja nga shtrati e lumit Erzen. Menjëherë, pas kqyrjes në terren të situatës, i kërkova Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit – Rajoni Durrës, të ndërhyhej me mjet eskavator krahëgjatë, në pamundësi të ndërhyrjes me mjet nga ana e Bashkisë Shijak.

Nga rreshjet gjatë periudhës 25-28 nëntor, ku here pas here në qarkun Durrës pati rreshje me intensitet të lartë u regjistruan 3 (tre) problematika:

Kanali i Ujërave të Larta, në Rajonin Nr.5, të Bashkisë Durrës (pavarësisht pastrimit të vazhdueshëm nga mbetjet plastike, përsëri ka prani të shisheve plastike, etj.) duke ndikuar në qarkullimin e ujit. Pas kërkesës drejtuar Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit – Rajoni Durrës, u bë e mundur ndërhyrja me 2 (dy) mjete eskavator. Për pasojë, nuk pati një dalje të ujit nga shtrati i Kanalit;

U përmblyt e një banesë në Rajonin Nr.1, të Bashkisë Durrës. Banesa është nën nivelin e rrugës. Pas njoftimit të ekipeve të M.Z.Sh-së Durrës u ndërhy me pompa thithëse, duke e larguar ujin. Pavarsisht, përpjekjeve nga ana e strukturave për evakuim në Shtëpinë e Pushimit, familjarët nuk pranuan; Aksi rrugor Krujë-Qafështamë si pasojë e rreshjeve të borës u bllokua, por ndërhyrja me fadromë borëpastruese bëri të mundur që rruga të qarkullohej përsëri.

Gjatë periudhës së nxehtë të vitit 2023, në fokus të vëmendjes së të gjitha strukturave operacionale kanë qenë zjarret. Duke e krahasuar me vitin e kaluar vihet re se ka një përmirësim në: "Sistemin e Raportimit" në dhënien e njoftimit në kohë për zjarr. Kjo gjë ka bërë që reagimi i strukturave operacionale të jetë në kohë, duke ndikuar në izolimin e shpejtë të vatrave të zjarrit. Nga ndjekja e situatës së zjarreve vihet re një ulje e dëmit të shkaktuar nga zjarri. Ky mirëmenaxhim i sezonit veror ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit mes gjithë strukturave operacionale: M.Z.SH-së, Policia e Shtetit, Repartit të M.Z.SH-së të Autoritetit Portual, strukturave përgjegjëse të bashkive. Duke krahasuar numrin e ngjarjeve të shkaktuara nga zjarret, në vitin 2022, vihet re një ulje e konsiderueshme në numrin e zjarreve në të 3 Bashkitë, kjo si rezultat i veprimeve reaguese në kohë nga të gjitha forcat operacionale.

ZJARRET NË PYJE, KULLOTA, HAMULLORE, SHKURRE, BARISHTE

INSTITUCIONI	VITI 2022	VITI 2023	NIVELI I PERMIRESIMIT
Bashkia Durrës	418	143	275
Bashkia Krujë	166	62	104
Bashkia Shijak	35	12	23
Totali	619	217	402

Për tu vlerësuar është puna e mirë nga Policia e Shtetit, e cila këtë vit ka pasur një vëmendje më të shtuar ndaj veprave penale të lidhura me zjarret.

DREJTORIA VENDORE E POLICISË - ANALIZA E ZJARREVE 2023

Vepra penale	Zbuluar	Arrestuar	Ndaluar	Ndjekje të lirë
Shkatërrim prone me zjarr	33	17	2	15
Shkatërrim prone nga pakujdesia	8	-	-	8
Shkatërrim me zjarr i pyjeve	1	-	-	-
Shkatërrim nga pakujdesia me zjarr i pyjeve	1	1	-	-
Total	49	18	2	23

KANALE TE PASTRUARA, ARGJINATURA

INSTITUCIONI	VITI 2022	VITI 2023	KOMENTE
Bashkia Durrës	58119 ml	24943 ml	Nisur nga përvoja e deritanishme, i është kushtuar një vëmendje e madhe ndërhyrjes në argjinatura në lumin Erzen, e cila e përkthyer në njësinë ml është 1500 ml (<i>Sukth dhe fshatin Rrotull</i>)
Bashkia Krujë	19907 ml	27032 ml	Në Thumanë, Luz, Tapizë, Bilaj, etj
Bashkia Shijak	12940 ml	3841 ml	Kanali i parë i njohur si “ <i>Kanali i Gjermanit</i> ”, në Hardhishtë dhe në kanalin vaditës Ndroq-Callike. Për shkak të një defekti të rëndë të mjetit eskavator puna ka ecur me ritme të ngadalta.
Totali	90966 ml	55766 ml	

Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Prefektit të Qarkut Durrës, gjatë vitit 2023 ka mbështetur punën e saj në zbatim të ligjshmërisë dhe objektivave të shtruara për realizimin e tyre në të gjithë veprimtarinë këtij sektori, në zbatim të ligjit “Për Prefektin e Qarkut”, të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjeve e udhëzimeve specifike në fushën e financës. Në zbatim të saj kemi patur bashkëpunim dhe me sektorët e tjerë të Prefekturës si dhe në kontakt e ndjekje të vazhdueshme dhe me njesitë e qeverisjes vendore në zbatim të kërkesave të reja të menaxhimit dhe efikasitetit më të mirë të burimeve financiare të vëna në dispozicion nga ana e buxhetit të shtetit. Në këtë periudhë, detyrat para punonjësve të Sektorit të Financës ishin në realizimin me efikasitet dhe kompetencë profesionale të gjithë aktivitetit të tyre.

Sektori Financës që në fillim të vitit në bashkëpunim me sektorët përkatës të Prefekturës Qarkut Durrës, bëri detajimin e buxhetit të vitit 2023 si dhe dha ndihmën parësore dhe për tre Bashkitë, me qëllim që detajimi dhe vënia në zbatim e këtij buxheti të bëheshin saktësisht dhe në kohë. Kjo është kryer si me detajimet buxhetore, paketat fiskale, mbylljet vjetore apo ndjekjen e problematikave qëshfaqeshin vazhdimisht në këto njësi. Po në këtë këndvështrim u punua dhe u krye dhe mbyllja e rezultatit ekonomik të Prefekturës si dhe u hartua programi vjetor i punës për vitin 2023.

Brenda muajit Janar 2023, u detajua buxheti i ri për vitin 2023 për administratën e Prefektit dhe Gjendjen Civile. Po kështu u hartuar Rregjistri i realizimit të Prokurimit Publik për vitin 2022 si dhe u hartuar e miratua Rregjistri i parashikimit të Prokurimit Publik për vitin 2023 të cilët u dërguan brenda afatit në Ministrinë e Brendshme dhe Degën e Thesarit.

Nëzbatim të Urdhërit nr.5 prot datë 06.01.2023 të Prefektit të Qarkut Durrës është përcaktuar struktura e administratës së Prefektit me 28 punonjës, (bashkë me 2 punonjës të gjendjes civile) sipas pozicioneve të punës dhe me emrat e punonjësve. Nga DAP janë hapur procedurat dhe është bërë emërimi në muajin mars 2023 për një specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Gjatë gjithë kësaj periudhe kanë qenë në marrëdhënie pune 26 punonjës, për të cilët janë kryer në afat hartimi i listpagesave, përlllogaritja e kontributeve dhe tatimit, përpilimi i urdhër shpenzimeve si dhe ndjekja e pagesave në Thesar dhe Bankë.

Mbeten dhe tre vende vakant; 1 Përgjegjësesi i Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjecave Civile dhe 2 specialistë në Sektorin Monitorimit të Kopetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara.

Gjatë vitit 2023, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, ka ndjekur përdorimin dhe administrimin e fondeve të vëna në dispozicion për aparatën e Prefekturës dhe atë të Gjendjes Civile. Kemi raportuar çdo muaj, evidencat e realizimit të treguesve buxhetorë në Ministrinë e Brendshme dhe në Degën e Thesarit.

Në buxhetin e vitit 2023, në total ku përfshihet Prefektura dhe Gjendja Civile, gjithsej janë 39,791,200 lekë, ku peshën më të madhe e zënë shpenzimet për paga të personelit në masën 27,131,000 lekë ose 68,2 %, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore 4,535,000 lekë ose 11,4 %, shpenzimet për mallra e shërbime 5,896.000 lekë ose 14,8% dhe investime 2.000.000lekëose 5%.

Ana kryesore e punës së institucionit të Prefektit është menaxhimi sa më racional i këtyre fondeve.

Në vitin 2023 realizimi i fondeve buxhetore është në masën 98.7 %, ose nga 39.791 mijë lekë të planifikuara në fakt janë shpenzuar 39.264 mijë lekë, pra më pak 527 mijë lekë.

Sipas zërave përkatës, pagesat për personelin u realizuan 98.98 % ose 276 mije lekë më pak. kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore u realizuan në masen 97.56%. %, pra më pak 111 mijë lekë. Për mallra e shërbime të tjera realizimi ishte në masën 98.87%. % ose nga 5.896mijëlekë në 5,829mijëlekë, pra më pak 67 mijë lekë. Për investime realizimi ishte në masën 96.3%. % ose nga 2.000 mijëlekë në1,926mijëlekë, pra më pak 74 mijë lekë. Transferta per buxhet familjar e individet realizuar 100 %, ne masën 229 200 lekë

Është bërë ndjekja e realizimit të Ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2023 të cilat raportohen për çdo muajnë Ministri dhe janë të konfirmuara nga Dega e Thesarit Durrës. Për këtë periudhë të ardhurat janë realizuar në total 462.300 lekë, nga të cilat 23.115 lekë, të ardhurat për Ministrinë e Brendshme dhe 439.185lekë, të ardhurat për Buxhetin e Shtetit. Pas datës 01.10.2023 nga ana e zyrtarëve të gjendjeve civile Durrës dhe Krujë është shërbyer vetëm online nëpërmjet e albania. Gjatë këtij viti vlen për tu lavdëruar, ku së bashku me komisionet përkatëse (komisioni i testimit, prokurimit dhe ai i marrjes në dorëzim), janë realizuar 18proçedura prokurimi me vlerë të vogël, nga 18 të planifikuara. Gjithashtu është dërguar në APPRegjistri i realizimit të proçedurave të prokurimit publik për çdo katër muaj si dhe ai vitit 2023.

Është realizuar mbajtja e sistemit të kontabilitetit të vlerave monetare dhe materiale, lëvizja e aktiveve, raportim për vendimmarrjen në funksion të realizimit të objektivave, përgatitja e

pasqyrave financiare të institucionit dhe depozitimi në degën e thesarit dhe Ministrinë e Brendshme. Eshtë bërë shpallja e vendeve të punonjesve me status nëpunësi në sistemin HRMIS sipas kriterëve të kërkuara në zbatim të Ligjit 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil" për -3 pozicione; nga keto 2 kategori ekzekutive + 1 drejtues i ulët. Është bërë hedhja e të dhënave të dosjeve individuale në këtë sistem dhe po punohet akoma për pasqyrimin e përvojës së punës duke ndjekur trajnime periodike pranë shkollës ASPA. U krye raportimi vjetor i nevojave për rekrutim në Ministrinë e Brendshme, si dhe gjendja mbi zbatimin e Ligjit 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil" tek Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil. Janë nxjerre urdhërat për 2 automjetet në dispozicion të administratës së Prefektit duke zbatuar Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 112, dt. 18.04.2014 "Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe shofereve si dhe disa rregulla për përdorimin e tyre", në zbatim të tij është bërë dhe plotësimi ditor i flete-autorizimeve të punonjesve të administratës, si dhe plotësimi mujor i flete-udhetimeve të shofereve të automjeteve. Nga ana e Arkiv-Protokollit janë kryer çdo ditë të gjitha veprimet për pranimin, rregjistrimin, ciklin dhe shpërndarjen e korespondencës në bazë të Ligjit nr. 9154 të vitit 2003 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat" si dhe rregullave të përcaktuara në rregulloren e Prefektit.

Është kryer menaxhimi dhe administrimi i faqes zyrtare të Prefekturës. Ku janë realizuar aktivitete dhe takime të ndryshme, të cilat janë publikuar si në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale.

e ka mbështetur punën e saj në zbatim të ligjshmërisë dhe objektivave të shtruar për realizimin e tyre në të gjithë veprimtarinë e këtij sektori, në zbatim të ligjit "Për Prefektin e Qarkut", të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe ligjeve e udhëzimeve specifike në fushën e financës. Në zbatim të saj kemi patur bashkëpunim dhe me sektorët e tjerë të Prefekturës si dhe në kontakt e ndjekje të vazhdueshme dhe me njësitë e qeverisjes vendore në zbatim të kërkesave të reja të menaxhimit dhe efikasitetit më të mirë të burimeve financiare të vëna në dispozicion nga ana e buxhetit të shtetit. Në këtë periudhë, detyrat para punonjësve të Sektorit të Financës ishin në realizimin me efikasitet dhe kompetencë profesionale të gjithë aktivitetit të tyre. Sektori Financës që në fillim të vitit në bashkëpunim me sektorët përkatës të Prefekturës Qarkut Durrës, bëri detajimin e buxhetit të vitit 2023 si dhe dha ndihmën parësore dhe për tre Bashkitë, me qëllim që detajimi dhe vënia në zbatim e këtij buxheti të bëheshin saktësisht dhe në kohë. Kjo është kryer si me detajimet buxhetore, paketat fiskale, mbylljet vjetore apo ndjekjen e problematikave që shfaqeshin vazhdimisht në këto njësi. Po në këtë këndvështrim u punua dhe u krye dhe mbyllja e rezultatit ekonomik të Prefekturës si dhe u hartua programi vjetor i punës për vitin 2023. Brenda muajit Janar 2023, u detajua buxheti i ri për vitin 2023 për administratën e Prefektit dhe Gjendjen Civile. Po kështu u hartuar Rregjistri i realizimit të Prokurimit Publik për vitin 2023 si dhe u hartuar e miratua Rregjistri i parashikimit të Prokurimit Publik për vitin 2023 të cilët u dërguan brenda afatit në Ministrinë e Brendshme dhe Degën e Thesarit.

Legalizimi i dokumentave.

Bazuar në VKM Nr.134 datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë për përdorim jashtë vendit dhe të dokumentave të huaja për përdorim brenda vendit” janë legalizuar **6639** dokumenta të lëshuara nga organet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Shqyrtimi i kundravajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor.

Në lidhje me kundravajtjet administrative, në zbatim të Udhëzimit Nr.687 datë 05.12.2013 “Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimi i gjobave në fushën e qarkullimit rrugor” janë shqyrtuar 15 praktika shkresore të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës.

PREFEKTI

EMILIAN JANI

Konceptoi: A.Murto

Pranoi: E. Çato

Konfirmoi: S.Zeqja

V.Rustani

L.Zeka

R.Metanj

D.Polena

Miratoi:

Sekretari Përgjithshëm

Edison Jonuzi

PREFEKTI I QARKUT DURRËS

EVIDENCË PËR AKTET NORMATIVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Janar -Dhjetor 2023

Verifikimi i Ligjshmërisë së Akteve të Organeve të Vetëqeverisjes Vendore												Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të ligjshme të bashkisë së atdhetit
Nr.	Njësi të vetëqeverisjes vendore	Akte të hyra tek Prefekti		Të bazuara në ligj		Të pabazuara në ligj		Me karakter individual		Të rishqyrtuara nga Nj.Q.V		
		Muj.	Prog.	Muj.	Prog.	Muj.	Prog.	Muj.	Prog.	Muj.	Prog.	
1	Këshilli i Qarkut Durrës	0	7	0	5	0	0	0	2			
2	Bashkia Durrës	0	150	0	47	0	0	0	103	0	0	
3	Bashkia Krujë	0	47	0	34	0	0	0	13			
4	Bashkia Shijak	0	19	0	19	0	0	0	0			
Shuma		0	223	0	105	0	0	0	118	0	0	0